

Parlament
ASH edhe
zyrtarisht mbeti
pa ministër

Fq.3



**GJIMNAZI
"7 MARS"**
Gjimnazi me
1500 nxënës
ende pa pedagog

Fq.5



Bëja 9 orë
rrugë me
autobus
për 2 orë
stërvitje

Fq.22



Koha

www.koha.mk

**Pse është kaq
i preferuar
Macroni**

Fq.15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3254 · e martë 26 dhjetor 2017

-1°C | +8°C

15 DEN

AKTUALE

**Serava e Gazi
Baba në terr**



Problemet urbane në Çair nuk kanë të përfunduar. Në kohën kur sulmet nga qentë endacak çdo ditë e më tepër po shtohen, banorët e Saravës, Gazi Babës e gjithandej druajnë se për shkak të mungesës së ndriçimit në disa prej mëhallëve brenda këtyre lagjeve, ato mund të jenë cak i ndonjë sulmi të papritur. Shprehjen e revoltës qytetare, ndonëse deri më tani banorët e këtyre lagjeve, por edhe më gjerë e kanë realizuar përmes reagi-meve të...

Fq.6

RAJON

**Anulimi i
Speciales
destabilizon
Kosovën**

Fq.14

DOSSIER

**KGB: Kur
diplomatët e
huaj ziheshin
në kurth
nëpërmjet
seksit**

Fq.16-17



KULTURA 2018-2022, VAZHDON DEBATI

SHUMË PIKËPYETJE PËR KULTURËN SHQIPTARE



Ky dokument që ende nuk është zyrtar - është publikuar në faqen elektronike të ministrisë, ndërsa të mërkurën do të prezantohet në debatin e fundit publik përpara se të marrë miratimin nga Qeveria dhe më pas nga Parlamenti. Sipas anëtarëve shqiptarë të grupit të punës, ky version i fundit, ka shumë paqartësi sa i takon strategjisë konkrete për zhvillimin e kulturës shqiptare në veçanti, por edhe për vetë mënyrën e realizimit të saj

Fq.7

Jovevski zyrtarisht prokuror shtetëror publik

Shkup, 25 dhjetor - Parlamenti i Republikës së Maqedonisë në vazhdimin e djeshëm të seancës së 22-të me 61 vota "pro", një abstenim dhe asnjë kundër e zgjodhi Ljubomir Jovevski prokuror shtetëror publik. Debati për zgjedhjen e tij dhe votimi u mbajtën pa praninë e deputetëve nga opozita. Prokurori publik ka mandat prej gjashtë viteve me të drejtë për emërim të serishëm. Jovevski (63) në punën e tij

të deritanishme ka vepruar në sferën penale. Më shumë se 15 vite ka punuar si gjykatës për lëndë penale, ndërsa në një mandat ka udhëhequr me Gjykatën Themelore Shkup 2, ndërsa ka edhe përvojë pune me mbi 12 vite si prokuror publik dhe shtatë vite në sferën e kryerjes së sanksioneve penale. Deri tani këtë funksion e ka kryer Liljana Spasevska, pasi Marko Zvërlevski u shkarkua më 17 gusht...

Fq.4



LAJMI I FUNDIT

THIRRJA E MBRETIT PËR TË HEQ DORË NGA NDARJA



Mbreti spanjoll Felipe i Gjashtë e shfrytëzoi fjalimin tradicional të Krishtlindjeve që në ditën e Buzmit t'i ftojë deputetët e sapozgjedhur në Parlamentin katalonas, të heqin dorë nga hapa të mëtejshëm për ndarje. "Rruga që është para nesh, nuk guxon edhe një herë të na sjellë deri në përplasje ose shkyçje e cila, siç e dini, vetëm krijon, mosmarrëveshje, pasiguri dhe brengje", theksoi monarku spanjoll në fjalimin e djeshëm televiziv. Mbreti Felipe theksoi se liderët katalonas duhet të "ballafaqohen me problemet që i godasin të gjithë katalonasit, duke e respektuar shumëllojshmërinë e tyre dhe duke menduar në mënyrë të përgjegjshme për të mirën e të gjithëve". Mbreti spanjoll pati fjalim mbrëmë, katër ditë pasi zgjedhjet parlamentare rajonale rezultuan me votim për kthim të partive separatiste në pushtet.

LIDERI OPOZITAR RUS SIGURON KANDIDATURËN PËR PRESIDENT

Disa qindra persona kanë përkrahur kandidaturën e liderit opozitar, Alexei Navalny, për president të Rusisë, ndërsa pritet vendimi i Administratës Zgjedhore, nëse ai do të ketë të drejtë të garojë për numrin një të shtetit. Kundërshtari më i denjë i presidentit aktual të Rusisë, Vladimir Putin, në 18 vitet e pushtetit të tij, Navalny, më



herët e kishte të ndaluar kandidimin nga shkaku i një verdikti penal lidhur me një rast të cilin ai e vlerëson si të motivuar politikisht. Mendohet se ai do të mund të ikte nga shteti, nëse do të merrte leje të posaçme, ose nëse verdikti pezullohet. Rreth 800 përkrahës të Navalnyt u mbledhën të dielën në një takim për t'i dhënë

përkrahje, ndërkohë pritet që nominimi i përbashkët t'iu dorëzohet autoriteteve zgjedhore, të cilat pastaj do të vendosin mbi një kandidim të mundshëm të tij. Fushata të cilën e drejton Navalny ka sensibilizuar masat edhe në pjesët më rurale të Rusisë. Megjithatë, presidenti aktual, Vladimir Putin, në bazë të sondazheve gëzon mbështetjen e mbi 80 për qind të votuesve, që e bën fitues të sigurt në zgjedhjet e ardhshme që do të mbahen në mars të vitit 2018.

TË VENDOSËSH MBI DIÇKA TË VENDOSUR

"Absurde është gjoja të vendosësh mbi diçka që asnjëherë nuk është varur prej teje dhe tashmë është vendosur nga vendimtarët", shkruan deputeti i BDI-së, Artan Grubi, duke aluduar në vendimin e Kuvendit të Aleancës për Shqiptarët.



KË PO RREZIKON MONIKA?

"Disa mendojnë se po merr pushtetin sot. Sikur të ndodhte 'mrekullia' sot - kjo do të thotë 'Monika e rrezikuar'. Stili i saj sapo ka nisur, ende nuk ka një klimë për atë lloj politike. Por deri tani ka mundur stilin e kryeministrit, i cili e pret gjahun në 'shtegun' e tij të frazimit, të të folurit jashtë rregullit, të figurave letrare të Faik Konicës. Në këtë gjueti ra edhe kryetari i PD, Basha nga ku nuk mundi të dalë. Disa e konsideruan edhe 'Zhan D'Arc' duke dashur t'i ndjellin fund të keq. Kryeministri Rama nuk reagoi ndaj 'dhunës' së Monikës, jo nga toleranca, por u ndodh para të papriturës se si dikush tjetër shpaloji 'stil të veçantë'", shkruan publicisti Frok Çupi në profilin e tij në Facebook.



ÇFARË JEMI NE?

"Një temë për debat: a bëhesh shqiptar nëse merr shtetësi shqiptar apo je shqiptar për shkak të përkatësisë etnike? Mediat e Republikës së Shqipërisë 'shqiptarë' i quajnë ata që kanë shtetësi të Republikës së Shqipërisë. Kjo, detyrimisht, e shtron pyetjen se çfarë janë shqiptarët e Luginës së Preshevës, të Malit të Zi dhe në të Maqedonisë?", shkruan nënkryetari i Lëvizjes BESA, Zeqirija Ibrahim."/>



SA VOTA, AQ FUNKSIONARË!

"Vesel Memedi paska 10 drejtori dhe një ministër në Qeverinë e Zaevit. Të kishte dalë vetë në zgjedhje nuk do merrte vota aq sa ka funksionarë. Është nip i Nafi Çegranit...", shkruan në profilin e tij në Facebook, Armend Nuhiu.



MITERANI DHE INTELEKTUALËT

"Dikur moti presidenti francez Fransua Miteran, kishte vizituar Londrën dhe pasi kishte përfunduar takimi protokollar me Margaret Thaçerin, kishte kërkuar prej saj të takohet me intelektualët anglezë. Fatkeqësisht, shefi i protokollit nuk e përmbushi kërkesën. Jo se nuk i kishte pranë, por pse mungonin intelektualë të tipit të Zhan Pol Sartri! Shefi i protokollit e kishte ditur saktë konceptin francez mbi intelektualin..., dhe nuk e kishte 'zgjatur këtë lojë' të presidentit francez. P.S. 'Helbete', ne shqiptarët, në një të ardhme të afërt, do të kemi një intelektual të tipit të Zhan Pol Sartër! (hiq mënjane Kadarenë)", shkruan publicisti dhe njohës i arsimit në Maqedoni, Fadil Lushi.



MEDIACitate

Mëngjesin e djeshëm, Fortlurturia e tij Anastasi udhëhoqi qindra besimtarë ortodoksë në Katedralen "Ngjallja e Krishtit" në Tiranë. Kjo ishte Mesha e parë e Krishtlindjes që ai kremton si shtetas shqiptar. Ndërsa besimtarët katolikë në katedralen e Shën Palit në Tiranë u lutën për më shumë paqe e mirësi në meshën tradicionale të Krishtlindjes, që u kremtua nga Arqipeshkvi i Arkidioqezes Tiranë-Durrësit, Imzot Xhorxh Frenndo. Duke folur para besimtareve ai tha se është një festë e madhe, e familjes dhe dashurisë. "Le të përkujdesemi që në këto ditë festive, të përjetojmë më thellë shenjtërinë dhe madhësinë e dhuratës së jetës që na e ka dhuruar Perëndia".

(gazeta shqip, 25 dhjetor)

Një sulm vetëvrasës ka ndodhur sot afër Agjencisë Kombëtare për Inteligjencë në Kabul, duke lënë të vdekur gjashtë civilë, kanë thënë forcat e sigurisë. Zëdhënësi i ministrisë së Brendshme, Nasrat Rahimi, ka thënë se sulmi ka ndodhur gjatë mëngjesit të djeshëm, afër hyrjes së kësaj agjencie. Selia e ambasadës amerikane dhe ajo e NATO-s gjenden po ashtu në këtë zonë.

Zëdhënësi i ministrisë për Shëndetin Publik, ka thënë se tre persona janë lënduar dhe dërguar në spital për trajtim.

(REL, 25 dhjetor)

Ushtarët izraelitë në Bregun Perëndimor nën pushtim kanë arrestuar 30 palestinezë. Në një deklaratë të publikuar nga ushtria e Izraelit, theksohet se në bastisjet e kryera gjatë Bregut Perëndimor janë arrestuar 30 palestinezë me pretendimin se janë "përfshirë në akte terroriste". Gjithashtu është bërë e ditur se 8 nga palestinezët janë nga fshati Kasra në jug të qytetit Nablus. Forcat izraelite shpeshherë kryejnë bastisje ndaj shtëpive në Bregun Perëndimor dhe Kuds Lindor nën pushtim, ku me pretendime të ndryshme arrestojnë palestinezët.

(Anadolu Agency, 25 dhjetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË ËSHTË KANUNI I LABËRISË?

Kanuni i Labërisë është përmbledhje e normave të pashkruara të së drejtës zakonore që kanë vepruar në krahinat midis tre urave: të Drashovicës, të Tepelenës e të Kalasës. Tradita gojore e lidh kanunin e Labërisë me emrin e papa Zhulit, themeluesit të katundit Zhulat (Gjirokastër). Rreth viteve 1840-1850 u bënë disa ndryshime në kanunin e vjetër të Labërisë. Këto ndryshime njihen me emrin "Shartet e Idriz Sulit".

Ndryshimet pasqyrojnë marrëdhëniet sunduese feudale dhe u përgjigjeshin interesave të agallarëve, të klasës sunduese feudale. derkaq ato u kundërviheshin ligjeve dhe sistemit gjyqësor të pushtuesve osmanë si dhe reformave të Tanzimatit. Kanuni i Labërisë ishte i mbledhur, por jo i kodifikuar. Normat e tij janë përgjithësisht të njëjta me ato të kanuneve të tjera.



PARLAMENTI ZGJODHI PROKURORIN PUBLIK DHE MINISTRAT E RINJ

ASH MBETI PA MINISTËR, SAZDOVSKI PLOTËSON SHUMICËN PARLAMENTARE



Paraprakisht, Syrija Rashidi kërkoi që të tërhiqet propozimi për emërimin e ministrave dhe zëvendësministrave, ndërsa kërkoi që pikë e parë e rendit të ditës të jetë Ligji për gjuhët, pasi siç arsyetoi ai, Ligji për gjuhët ka kaluar tashmë filtrat e komisioneve parlamentare. Megjithatë, kundër propozimit të Rashidit votuan deputetët e LSDM-së, ndërsa me 62 vota u miratuan emrat e rinj për plotësimin e kabinetit qeveritar

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 25 dhjetor - Deputeti nga radhët e partisë GROM, Çedomir Sazdovski, që më parë ishte në koalicion me VMRO-në, ishte çelësi që shumica parlamentare ti sigurojë 61 vota dhe të zgjedh të hënën Prokurorin e ri Publik, Lubomir Jovevski. Paraprakisht votimi dështoi dy herë për shkak të mungesës së deputetes nga radhët e BDI-së, Shpresa Hadri për arsye objektive, ndërkaq pas dhënies së pauzës për gjysmë ore, por që zgjati më shumë se një orë, me ardhjen e deputetes Hadri, prokurori Lubomir Jovevski mori 61 vota nga 62 sa ishin prezent në sallë, përfshirë dhe deputeten e PDSH-së, Merale Yzeri Ferati, e cila nuk votoi fare. Deputetët e ASH-së, Ziadin Sela dhe Syrija Rashiti nuk ishin prezent në sallë. Pas mbarimit të seancës, deputeti i BDI-së, Artan Grubi u kthye nga gazetarët, ndërsa përsërishte refrenin "e zgjedhëm prokurorin pa Aleancën, pa PDSH-në, pa BESËN dhe pa Amdi Bajramin". Paraprakisht, Syrija Rashidi kërkoi që të tërhiqet propozimi për emërimin e ministrave dhe zëvendësministrave, ndërsa kërkoi që pikë e parë e rendit të ditës të jetë Ligji për gjuhët, pasi siç arsyetoi ai, Ligji për gjuhët ka kaluar tashmë filtrat e komisioneve parlamentare.

SHUMICA SIGURON 62 VOTA

Megjithatë, kundër propozimit të Rashidit votuan deputetët e LSDM-së. Dhe pas kësaj, shumica në Parlament me 62 vota "për" votoi edhe ministrat dhe zëvendësministrat e propozuar nga LSDM dhe BDI, ai për Shëndetësi - Venko Filipçe, ministër pa resor Amsel Ahmedovski nga par-



Shpresoj se nëse vendimi i tyre është të mbeten në Qeveri, kjo do të thotë pranim i nënkryetarit të Qeverisë për reforma", deklaroi kryeministri Zaev



Parlamenti të hënën ka konstatuar edhe dorëheqjet e anëtarëve të Komisionit Shtetëror Zgjedhor. Tetë nga nëntë anëtarë para më shumë se një javë ofruan dorëheqjet pas presionit të opinionit lidhur me nëntë pagabonuse që vet KSHZ i kishte miratuar për anëtarët e saj.

tia e romëve, zëvendësministër i Arsimit, Arbër Ademi dhe për zëvendësministër të Bujqësisë - Bllage Cvetkoviç. Por pavarësisht kësaj, shihej hapur se shumica parlamentare pa dy deputetë e ASH-së është e brishtë. Në rrethanat në të cilat po kalon vendi me agjendën reformuese të Qeverisë, me çështjen e emrit dhe kur duhen vota për Ligjin për gjuhën shqipe, kur duhen edhe tre të katërtat e votave për ligje organike, lë shumë për të dëshiruar loja me numrat në Parlament dhe loja tërhiq e mos e këput me Aleancën për Shqiptarët, e cila ishte vendimtare që kryeministri i tanishëm Zoran Zaev të merr mandatin nga presidenti Iavnov për të formuar Qeverinë. Nga ana tjetër, në procedurë parlamentare vetëm tani pas formimit të Qeverisë dhe pas zgjedhjeve lokale, janë një sërë ligjesh duke filluar nga ato që prekin sferën e gjyqësorit e deri tek ligjet që prekin sferën e ekonomisë për miratimin e të cilëve duhet që të ekzistojë një shumicë stabile parlamentare. Të dielën kur opinion priste që ASH të merr vendim të del nga Qeveria, kjo partie la të hapur mundësinë që të qëndrojë në Qeveri, siç e arsyetoi kryetari Sela, për shkak se ende është në fuqi marrëveshja e koalicionit dhe qëllimi që të realizohen kërkesat e shqiptarëve mes tyre dhe Ligji për shqipen. Ndonëse u zgjedh ministri i ri i Shëndetësisë nga radhët e LSDM-së, kjo e fundit nuk ka filluar biseda qofte dhe jozyrtare me PDSH-në për të mbajtur stabile shumicën parlamentare, qoftë me pjesëmarrjen e saj në Qeveri apo vetëm ti japë përkrahje një Qeveri të pakicës me ASH-në jashtë saj.

Kur jemi tek pozicioni i ASH-së, kryeministri Zoran Zaev të hënën për-

sëriti qëndrimin se ASH tani ka dy deputet dhe se ministria e Shëndetësisë nuk mund ti takojë më ASH-së, ndërsa foli fjalë të mëdha për postin e zëvendëskryeministrit për reforma që i është ofruar ASH-së. "Ju e dini që në më shumë se një muaj kemi biseduar për këto çështje, bëhet fjalë për parti politike e cila ka dy deputetë. Ministria e Shëndetësisë është një nga resorët më të rëndësishëm në Qeverinë e Maqedonisë, dhe në momentin kur u formuar kjo Qeveri u dha edhe për shkak kandidatit. Shumë e rëndësishme është se cili kandidat ofrohet, atëherë ishte Arben Taravari, dhe për këtë shkak tani nuk kemi mundur të bëjmë paralele nga i llojit të tillë dhe mbeti që këtë vend ti takojë LSDM-së", ka thënë Zaevi pas ishte në Gjykatën Penale, për shkak të gjyqimit për lëndën "Mitmarra" ku si kryetar i Komunes së Strumicës është i dyshuar për kërkesë dhe për marrje të mitos në vlerë prej rreth 160 mijë eurove. I pyetur nëse do të ketë takim të ri me Ziadin Selën, liderin e Aleancës për shqiptarët, Zaev tha se mbi një muaj bisedojnë për këtë çështje. "Shpresoj se nëse vendimi i tyre është të mbeten në Qeveri, kjo do të thotë pranim i nënkryetarit të Qeverisë për reforma", deklaroi Zaev. Ai theksoi se as Arben Taravari, as Ziadin Sela nuk e kanë informuar dhe ai ka dëgjuar nga mediumet për vendimin e tij të shkojë si kandidat për kryetar komune. "Bëhet fjalë për parti politike e cila ka dy vende deputetësh. Ministria e Shëndetësisë është një ndër resorët më të rëndësishëm në Qeveri dhe në momentin kur ishte ofruar gjatë konceptimit, ishte dhënë edhe për shkak të kandidatit. Ne e ofruam vendin e nënkrye-

tarit për reforma duke e pasur parasysh se me të vërtetë është parti e re që do të dëshirojë të dëshmohet. Besuam se kjo do të ishte e pranueshme për ta", tha kryeministri.

ASH UDHËHEQ 6

NGA 14 DREJTORI SA I TAKOJNË

Ndonëse Zaev përmendi 20 institucione që i takojnë ASH-së për ti udhëhequr, nga ASH njoftuan se ata momentalisht udhëheqin vetëm me gjashtë prej tyre, ndërkaq 14 drejtori që aktualisht i mban BDI kjo e fundit ka bërë obstrukcione të mos i lëshojë. "Zaev tha 20 drejtori, por që nga koha kur jemi marrë vesh, BDI ka bërë obstrukcione mos t'i lëshojë disa drejtori, dhe ne aktualisht udhëheqim me 6 prej tyre dhe 14 drejtori ende jemi në pritje që ti marrim nën udhëheqje. Mos të harrojmë edhe faktin tjetër që RDK udhëheq me një ministri, e cila nuk është në koalicion me ne, ndërsa ministrinë e ka për shkak mijëra votave që kishte partia jonë në zgjedhjet parlamentare dhe këtë fakt e di mirë Zoran Zaev e që nuk mund aq lehtë ta anashkalojë dhe të bën lojë me zëvendëskryeministër për reforma", theksoi për gazetën KOHA, Flakron Bexheti, zëdhënës i ASH-së. I njëjti në një postim në Facebook ironizoi me ndodhitë e djeshme në Parlament. "Mungojnë votat e mjaftueshme në Parlament për ta zgjedhur Prokurorin e përgjithshëm. Është koha ta kuptojë LSDM se ASH dhe Ziadin Sela është shtylla e kësaj qeverie, dhe se ndihmon dot as Amdi Bajram, as ata që presin tek dera. Respektojeni marrëveshjen e 27 Prillit. Është interes i shtetit, i reformave dhe i shpresës", thotë Flakron Bexheti.

Nëse nuk sillet

Buxheti i komunës, do të kërkojmë zgjedhje të reja lokale

Gostivar, 25 dhjetor - Kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari, duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve rreth pasojave të mundshme nga sjellja e buxhetit të komunës, si një prej mundësive për tejkalimin e përlëshjeve është shpallja e zgjedhjeve të reja lokale. Sot në konferencë për shtyp ai i komentoi gjendjet në vetëqeverisjen lokale dhe ka dhënë vlerësim. "Në qoftë se nuk vihet as si pikë e rendit të ditës në afatin kohor të përcaktuar ligjërisht, ndërsa propozimi për buxhetin është dorëzuar në kohën e duhur, unë si kryetar komune jam i detyruar ta informoj Ministrinë e Financave dhe të kërkoj financim të përkohshëm në lartësi prej një të tretat e buxhetit për vitin 2017, siç është përcaktuar me ligj. Do të presim deri të premtën, të paktën të vihet në rend dite. Pastaj do ta shqyrtojmë mundësinë e shpalljes së zgjedhjeve lokale, nëse buxheti nuk kalon. Sepse kjo është një nga mundësitë për shpërndarjen e kështillit, nga shkaku se në një rast të tillë nuk mundemi as të funksionojmë si komunë", tha Taravari. Në konferencën për shtyp, në lidhje me të gjitha dilemat me pengesat që çuan në vonesën e pagave dhe revoltit të mësimdhënësve, ai theksoi se në iniciativë të rij është tejkaluar situata dhe se sot në seancë të jashtëzakonshme është sjellë vendim në dobi të kuadrit të mësimdhënësve. Taravari në këtë rast i akuzoi kundërshtarët për obstrukcione. "Kjo shumicë përipiqet të bllokojë vazhdimisht, siç është sjellja e buxhetit komunal për vitin 2018 deri më 31 dhjetor. Por do të doja të ju informoj se mbarëvajtja e punëve në komunën e Gostivarit praktikisht frenohet prej 16 këshilltarëve nga radhët e BDI-së, LSDM-së, partisë së Vesel Mededit dhe këshilltar të DSR-së Kashmir Saliu", tha kryetari i komunës. Ai shpjegoi se, ata kanë disa kërkesa të çuditshme. "Ata kërkojnë të punësojnë ushtarë partiakë në arsim Gjëja e dytë është që ata kërkojnë të marrin paga personat që nuk vijjnë aspak në punë. Për këto gjëra unë nuk ka se pse bisedoj me ta", ishte decid kryetari i komunës.

ME 61 VOTA "PËR" DHE PA OPOZITËN NË PARLAMENT

JOVEVSKI EDHE ZYRTARISHT PROKUROR SHTETËROR PUBLIK



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 25 dhjetor - Parlamenti i Republikës së Maqedonisë në vazhdimin e djeshëm të seancës së 22-të me 61 vota "pro", një abstënim dhe asnjë kundër e zgjodhi Ljubomir Jovevski prokuror shtetëror publik. Debati për zgjedhjen e tij dhe votimi u mbajtën pa praninë e deputetëve nga opozita. Prokurori publik ka mandat prej gjashtë viteve me të drejtë për emërim të serishëm. Jovevski (63) në punën e tij të deritanishme ka vepruar në sferën penale. Më shumë se 15 vite ka punuar si gjykatës për lëndë penale, ndërsa në një mandat ka udhëhequr me Gjykatën Themelore Shkup 2, ndërsa ka edhe përvojë pune me mbi 12 vite si prokuror publik dhe shtatë vite në sferën e kryerjes së sanksioneve penale. Deri tani këtë funksion e ka kryer Liljana Spasevska, pasi Marko Zverlevski u shkarkua më 17 gusht të këtij viti. Në deklaratën e solemne, Jovevski u obligua se

do ta respektojë Kushtetutën dhe ligjet dhe se do të punojë me nder, me vetëdije dhe në mënyrë të paanshme. Do të punojë në kthimin e besimit të qytetarëve në prokurorinë Publike. "Jemi para një sfide të madhe që ta kthejmë besimin e humbur në punën e Prokurorisë para qytetarëve dhe të profilizohet si institucion profesional i cili do t'i ndjekë autorët e veprave penale. Për këtë shkak do të punoj që Prokuroria ta mbrojë ligj-

shmërinë dhe të sigurojë sundim të së drejtës në Republikën e Maqedonisë". Ai e siguron opinionin se Prokuroria do të distancohet nga pushteti ekzekutiv dhe qendrave të tjera të fuqisë dhe do të jetë organ i pavarur shtetëror kompetent për ndjekjen e krimit. "E garantoj pavarësinë në veprimin e prokurorëve publikë dhe insistoj ta hulumtojnë dhe ndjekin krimin dhe korrupsionin, ndërsa vendimet e tyre të marrin ja-

Joveski tha se ka pasur kontakte me PSP-në dhe se dukshëm është përmirësuar bashkëpunimi. Ende është herët, thotë ai, të flitet cila do ta jetë lënda e parë. Ligji për amnisti, siç tha Koveski, është puna e Parlamentit nëse do të miratojë apo jo dhe nuk do të përzihet në të

shtëzakonisht në bazë të dëshmimeve dhe fakteve që do të vërtetohen, ndërsa konfirmimi i të vërtetës ta kenë qëllim prioritar", tha prokurori i ri publik. Joveski tha se ka pasur kontakte me PSP-në dhe se dukshëm është përmirësuar bashkëpunimi. Ende është herët, thotë ai, të flitet cila do ta jetë lënda e parë. Ligji për amnisti, siç tha Koveski, është puna e Parlamentit nëse do të miratojë apo jo dhe nuk do të përzihet në të.

PARABURGIM EDHE PËR KATËR PERSONA TJERË PËR DHUNËN E 27 PRILLIT

Paraburgim prej 30 ditësh gjykatësi i procedurës paraprake u caktoi edhe katër personave të tjerë, të cilët janë të pakapshëm për organet e ndjekjes, ndërkaq që morën pjesë në ngjarjet e 27 prillit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. "Gjykatësi i procedurës paraprake pranë Gjykatës Themelore Shkup 1, pas njoftimit të marrë nga organet kompetente se personat A.V., N.M., M.D. dhe D.D. të përfshirë me propozimin e PTHP-së për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit për përcaktim të masës së paraburgimit, ndërkaq lidhur me

ngjarjet e 27 prillit në Kuvendin e RM-së, janë të pakapshëm për organet për ndjekje, solli vendim me të cilët të gjithëve u caktoi masë paraburgimi në kohëzgjatje prej 30 ditëve pas gjetjes së tyre, përkatësisht privim nga liria, për shkak të ekzistimit të shkaqeve të parapara në LPP", ceket në kumtesën e sotme të gjykatës. Ekzemplarë nga vendimet, menjëherë pas përgatitjes së tyre, nga gjykata janë dërguar në prokurorinë kompetente, ndërkaq urdhër për shpallje të fletë arrestit, në pajtim me dispozitat e ligjit, sjell organi i cili e udhëheq procedurën.

ANGJUSHEV PËR KANAL 77

EMRI DUHET TË ZGJIDHET, POR TË MOS LËSHOHET PE PËR IDENTITETIN



Shkup, 25 dhjetor - Çështja e emrit duhet të zgjidhet. Maqedonia Veriore, e Epërme apo e Re, për këtë

populli duhet të prononcohet. Për mua Veriore, e Epërme dhe e Re është e pranueshme, deklaroi zëvendëskryeministri Koço Angjushev në edicionin e së shtunës në emisionin "Stadiumi" në Kanal 77. Sipas tij, zgjidhja e çështjes së emrit është edhe çështje e brendshme dhe kjo lidhet edhe me ekonominë, pasi që nëse për prosperitet ekonomik duhet krahas masave ekonomike të ketë edhe qeverisje të së drejtës dhe gjendje politike

stabile, ndërsa për këtë Maqedonia duhet të jetë anëtare e BE-së dhe NATO-s. "Të gjitha parakushtet që të mund ta bëni atë është të gjeni zgjidhje dhe kompromis për emrin. Jam i vetëdijshëm se kjo duhet të zgjidhet. Kjo Qeveri ka kapacitet dhe transparencë të bisedojë në këtë temë, e shohim se ka sinjale pozitive edhe prej bashkësisë ndërkombëtare, duke e përfshirë edhe palën greke. Linja e kuqe për të cilën nuk duhet lëshuar pe është

identiteti, identiteti maqedonas, gjuha... dhe se për emrin duhet ta bëjmë një përcaktues i cili do të jetë i pranueshëm ndërkombëtarisht. Unë jam i mendimit se kjo çështje duhet të zgjidhet. Maqedonia Veriore, e Epërme apo e Re, për këtë populli do të vendos. Për mua edhe e Veriut dhe e Epërme edhe e Re është zgjidhje e pranueshme", tha Angjushev. Lidhur me rritjen e tatimeve, Angjushev elaboroi se në Qeverinë e tanishme askush

nuk diskuton për rritjen e TVSH-së, të tatimit të fitimit, të tatimit të pronës. Flitet vetëm për rritjen e tatimit personal dhe vetëm tek kategoritë e pasura të qytetarëve. Thotë se duhet të bëhet një baraspeshë më e mirë sociale në shtet. Sipas tij, gjendja në administratë ku njëra anë ka stërngarkim ndërsa pjesa tjetër mungesë të kadrove përkatëse profesionale do të zgjidhet me të ashtuquajturat mekanizma të buta.

PËR SHKAK TË MOS FINANCIMIT TË VENDEVE TË REJA TË PUNËS

GJIMNAZI ME 1500 NXËNËS ENDE PA PEDAGOG



I kthyer në subjekt të pavarur juridik që në 2015-ën, gjimnazi "7 Marsi" nuk ka pedagogun dhe psikologun e shkollës as sot e kësaj dite. Nga Komuna e Tetovës, përgjegjësi për arsim Amet Qazimi, thotë se janë dërguar në paket kërkesat për nevojat kadrovike të gjithë shkollave që para fillimit të vitit 2017/2018. Për shkollat fillore, MASH ka kthyer të gjitha përgjigjet negative, kurse për shkollat e mesme përgjigjet nuk janë kthyer ende

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 25 dhjetor - Nuk është kthyer asnjë përgjigje pozitive për financimin e vendeve të reja të punës në shkollat fillore dhe të mesme në Komunën e Tetovës. Në përjashtim të dhënies së pëlqimeve nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për kërkesat që kanë të bëjnë me shtimin e orëve të mësimi të disa arsimtarëve të angazhuar në shkollat fillore, çështja e të gjitha kërkesave që kanë të bëjnë me financimin e vendeve të reja, ka mbetur në vendnumëro. Përgjegjësi për arsim në Komunën e Tetovës, Amet Qazimi, thotë se janë bërë në kohë të gjitha kërkesat dhe janë respektuar gjithashtu afatet kohore për informimin në kohë të Ministrisë së arsimit për nevojat kadrovike që kanë shkollat e kësaj komune. "Mirëpo, tani për tani gjendja me punësimet e reja, respektivisht me financimin e vendeve të reja të punës nuk ka ndryshuar ende. Për kërkesat e shkollave fillore na është kthyer përgjigje negative, ndërsa për kërkesat që kanë të bëjnë me shkollat e mesme - nuk kemi

marrë ende asnjë përgjigje", pohon ai.

Qazimi ankohet se komunat kanë vazhdimisht problem me çështjen e punësimi të kuadrove nëpër shkolla, qofshin ato në mësimdhënie, shërbime profesionale apo administrative. Për pasojë, para fillimit të secilit vit të ri shkollor, dërgohen nga 10-12 kërkesa. Kështu ndodhi edhe para shtatorit të këtij viti kur nga Komuna e Tetovës deri te institucioni i MASH-it kishin dërguar kërkesat për financimin e vendeve të reja të punës në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës të Tetovës, disa prej të cilave ishin kërkuar edhe një apo dy vite më parë. Në këtë paket janë edhe kërkesat për plotësimin e vendeve të punës në gjimnazin "7 Marsi".

Me rreth 1500 nxënës, gjimnazi "7 Marsi" edhe pse është shkollë më vete (subjekt i pavarur juridik) prej dy vite e gjysmë nuk ka as sot e kësaj dite pedagog dhe psikolog. Këtë e konfirmon edhe përgjegjësi për arsim në Komunën e Tetovës. "Shërbimet profesionale, pra pedagogu dhe psikologu për këtë gjimnaz mungojnë. Padyshim që në pakon e

kërkesave, të cilat i patëm dërguar para fillimit të vitit shkollor 2017/2018, janë edhe ata për financimin e vendeve të punës pedagog, psikolog dhe për shërbimet e administratës. Mirëpo, nuk na është kthyer ende përgjigje për asnjë prej kërkesave tona për kuadrot e shkollave të mesme", sqaron Qazimi. Sakaq, lidhur me kërkesat që kishim për financimin e vendeve të punës nëpër shkollat fillore, përgjigjet thotë se janë kthyer negative. "Arsyetimi është se nuk janë siguruar lejet e financimit të atyre vendeve të punës nga Ministria e Financave. Sapo MASH të sigurojë ato leje, do të informohemi dhe ne si Komunë dhe do të na jepet pëlqimi për punësimet përkatëse".

Përveçse me mësimdhënës dhe personel të shërbimeve profesionale, shkollat kanë edhe mungesa të personelit nga shërbim administrativ. Mungesat e fundit, komunat e kanë më të lehtë ti plotësojnë, pasi angazhojnë personat e punësuar në Komunë. Pra edhe pse punojnë në shkollë, fillore apo të mesme, ata paguhën si të punonin në komunë.

27 aksidente në Shkup, një i vdekur

Shkup, 25 dhjetor - Një person vdiq në një prej gjithsej 27 aksidenteve të regjistruara gjatë fundjavës së kaluar në rajonin SPB Shkup. Në gjashtë aksidente lëndime të rënda kanë marrë dy persona, ndërsa në 15-të lëndime të lehta kanë marrë 21 persona.

Nëntë aksidente kanë qenë me dëme materiale. Siç informojnë nga MPB, gjatë fundjavës policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. Gjashtëdhjetë e nëntë shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara,

pesë shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe dhe tre shoferë nuk kanë dhënë përparësi për parakalim.

Nga trafiku janë përjashtuar 14 shoferë sepse e kanë drejtuar automjetin para se ta marrin patentën dhe 15 automjete me afat të skaduar të patentës.

Janë sanksionuar edhe 16 këmbësorë të cilët kanë kaluar jashtë kalimit për këmbësorë. Janë hasur edhe 200 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special "karrotreci" janë larguar 181 automjete.

Padi për ish-kryetarin e Koçanit

Shkup, 25 dhjetor - Kundër ish kryetarit të Komunës së Koçanit R.D (61) është parashtruar padi penale nga ana e Zyrës së Jashtme për punë kriminale - Koçan për shkak të dyshimit të bazuar për vepër të kryer penale "keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit". "I denoncuari, si kryetar i komunës së Koçanit, prej dhjetorit të vitit 2013 deri në prill të vitit 2014, pa vendim të sjellë paraprakisht nga Këshilli i komunës së Koçanit për subvencionim të transportit publik në rajonin e komunës, ka lidhur Marrëveshje për kryerjen e transportit publik për periudhën provë me "Avtom Atom" SHPK Koçan, në bazë të së cilës, për çdo biletë të shitur të transportuesit, komuna ka subvencionuar gjysëm nga shuma. Në këtë mënyrë, i denoncuari i ka mundësuar "Avto Atom" SHPK Koçan të fitojë dobi të kundërligjshme pronësore, ndërsa e ka dëmtuar buxhetin e komunës së Koçanit për 3.000.690 denarë", kumtoi MPB.

KRONIKË

Digjet ferma në Sedllarcë

48 vjeçari J.I nga fshati Sedllarcë e Epërme ka denoncuar se të dielën mbrëma rreth orës 20 e 30 minuta ka shpërthyer zjarr në fermën e tij. Me këtë rast janë djegur 600 ballë kashtë dhe konstruksioni i kulmit. Me intervenimin e zjarrfikësve të Tetovës, zjarri është lokalizuar. Sipas informatave të para, zjarri ka shpërthyer për shkak të rrejtimit elektrik, ndërsa dëmi është vlerësuar rreth 300 mijë denarë.

Aksidentohen me traktor, tre të lënduar

Në rrugët lokale që lidh fshatrat Kamjan dhe Jellovjan, të dielën rreth orës 13 e 30 minuta, një traktor IMT pa targa që e ka drejtuar 59 vjeçari A.I nga fshati Kamjan, ka humbur kontrollin dhe ka dalur nga rruga. Me këtë rast, një 33 vjeçar dhe një vajzë 11 vjeçare, të cilët kanë qëndruar në një rimorkio të improvizuar kanë marrë lëndime trupore të rënda. Me veturë tjetër dy të lënduarit janë dërguar në Spitalin e Tetovës, por pas marrjes së Ndihmës së Parë, janë dërguar për mjekim të Klinikat e Shkupit. Sipas informacioneve të para të hetimit, mospërshtatja e shpejtësisë ka qenë shkak për këtë aksident.

Aksident në rrugën Tetovë-Shkup, tre të lënduar

Të dielën rreth orës 18 në rrugën Shkup-Tetovë, veturë e tipit Golf më targa të Tetovës, e drejtuar nga 48 vjeçari A.Xh nga Reçica e Vogël, për shkak të mospërshtatjes së shpejtësisë me kushtet në rrugë, ka humbur kontrollin dhe ka goditur në mburojat prej metali. Tre bashkudhëtarë në veturë, të moshës 3, 19 dhe 24 vjeç kanë marrë lëndime trupore dhe pas marrjes së ndihmës së parë, janë lëshuar për mjekim shtëpiak.

Është dëmtuar një tren në afërsi të Gostivarit

Treni i udhëtarëve nr.660 që qarkullon në relacionin Shkup-Kërçovë, dje në orën 18:10 ka hasur dhe ka goditur në gurët e vendosur në pjesën e hekurudhës mes stacioneve hekurudhore Zherovjan dhe Gostivar, me ç'rast nga goditja është shkaktuar dëmtimi i motorit dhe amortizuesit, për ç'shkak treni menjëherë ka ndaluar pas goditjes. Siç informon MPB, nuk ka udhëtarë të lënduar, ndërsa komunikacioni hekurudhor në atë pjesë të hekurudhës ishte ndërprerë. Në orën 23:00 komunikacioni është normalizuar.

Aksident afër Kamjanit, dy të lënduar

Në autostradën Gostivar-Tetovë, të dielën mbrëma në afërsi të kthesës për në Kamjan, veturë e tipit Mazda 3, me targa të Tetovës, që e ka drejtuar 26 vjeçari M.B nga fshati Saraqinë, ka humbur kontrollin dhe ka dalur nga rruga. Në këtë aksident, vozitësi dhe bashkudhëtarja pas marrjes së ndihmës në Spitalin e Tetovës, janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Në këtë aksident janë dëmtuar puseta prej betoni, shtylla prej metali dhe 20 metër mburojë prej metali. Sipas policisë, shkak për këtë aksident ka qenë mospërshtatja e shpejtësisë me kushtet në rrugë. (U.H)

PJESA E VJETËR E SHKUPIT ME PROBLEME TË VJETRA

SERAVA E GAZI BABA NË TERR



Javëve të fundit, kur flasim për probleme me ndriçimin e hapësirës publike, në rrugët siç janë "Krimaska" e "Kosta Abrasheviq" në Seravë, "Bajram Shabani" e "393" në Gazi Babë, është regjistruar errësirë e plotë

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 25 dhjetor - Problemet urbane në Çair nuk kanë të përfunduar. Në kohën kur sulmet nga qentë endacak çdo ditë e më tepër po shohen, banorët e Saravës, Gazi Babës e gjithandej druajnë se për shkak të mungesës së ndriçimit në disa prej mëhallëve brenda këtyre lagjeve, ato mund të jenë cak i ndonjë sulmi të papritur. Shprehjen e revoltës qytetare, ndonëse deri më tani banorët e këtyre lagjeve, por edhe më gjerë e kanë realizuar përmes reagimeve të ndryshme, qoftë në media apo në rrjetet sociale, ato theksojnë se nëse nuk përmirësohen kushtet - do të vetorganizohen në zgjidhjen e problemit.

Javëve të fundit, kur flasim për probleme me ndriçimin e hapësirës publike, në rrugët siç janë "Krimaska" e "Kosta Abrasheviq" në Seravë, "Bajram Shabani" e "393" në

Gazi Babë, është regjistruar errësirë e plotë. Pamjet e errëta edhe pse i prekin të gjithë banorët e kësaj ane të qytetit të Shkupit, megjithatë shqetësimi më i madh vërehet te ato qytetarët të cilët e vizitojnë spitalin gjinekologjik "Nëna Tereza" në Seravë dhe nxënësit e shkollës fillore "Liria". Pikërisht rruga "Kosta Abrasheviq" që shpie drejtë spitalit gjinekologjik në Seravë, e cila është e lidhur me bulevardin "Cvetan Dimov" pas përfundimit të ditës, gjegjësisht prej orës 16:30 është në errësirë totale. Situata e ngjashme paraqitet edhe para hyrjes kryesore të shkollës fillore "Liria", respektivisht pjesa e parkingut dhe hyrja për në brendësi të lagjes Gazi Babë, pjesë kjo që shfrytëzohet nga nxënësit gjatë orëve të mbrëmjes është krejtësisht e errësuar.

Autoritet e Komunës së Çairit, në një prononcim për gazetën

KOHA, njoftojnë se i kanë parasysh të gjitha problemet e periudhës së fundit, sa i përket çështjes së ndriçimit publik. Lidhur me këtë situatë, ata premtojnë se brenda kësaj jave dhe periudhës që pason - do të intervenohet në sanimin e problemit. "Reagimet dhe ankesat e drejtpërdrejta të qytetarëve kanë arritur edhe në adresë të komunës. Për këtë arsye, shërbimet kompetente dhe personat përgjegjës kanë hartuar një plan gjithëpërfshirës, i cili gjatë ditëve në vazhdim do të zbatohet në zgjidhjen e problemit të fundit që është paraqitur, e që ka të bëjë me ndriçimin publik. Banorët e lagjeve të prekur duhet ta kenë parasysh se bëhet fjalë për një defekt më serioz dhe se për zgjidhjen e tij duhet pak më tepër kohë. Për këto arsye kërkojmë mirëkuptim nga qytetarët", thonë nga Komuna e Çairit.

Qytetarët e ndërgjegjshëm, përderisa shprehin revoltën e tyre

për këtë çështje, nuk ngurojnë të thonë se keqpërdorimi i rrymës nga shumë amvisëri, përfshi edhe biznese joformale, paraqet një prej shkaqeve kryesore se pse ato jetojnë në këto kushte. Djegia e shumë trafave elektrike, ngarkesa e madhe e shtyllave elektrike e kështu me radhë, brenda lagjeve Seravë, Gazi Babës sidomos gjatë periudhës së dimrit - mendohet të jetë arsyeja kryesore e cila ndikon që mëhalla të tëra të mbesin pa ndriçim publik. Ndryshe, vendosja nën tokë e sistemit përçues të rrymës elektrike apo e lidhjeve tjera, siç janë interneti e shërbimet tjera në lagjet si Serava e Gazi Baba, po thuhet se është e pamundur. Uzurpimi i trotuareve dhe ndërtimi i objekteve të forta të banimit buzë rrugëve kryesore, nënkupton se një pjesë të madhe të fajit, për kaosin e vërtet që mbizotëron në këtë pjesë të komunës, i takon edhe vetë qytetarëve.

Derivatet shtrenjtohen për gjysëm denari

Shkup, 25 dhjetor - Çmimet me pakicë të benzinës dhe diselit prej të hënës në mesnatë rriten për një denarë, ndërsa vajit ekstra të lehtë për amvisëri për një denarë. Sipas vendimit të Komisionit Rregullator për Energjetikë çmimi i ri i Eurosuper BS-95 do të arrijë 66.50 denarë, i Eurosuper BS-98 do të arrijë 68 denarë për litër, i Eurodiselit 55 denarë dhe vajit ekstra i lehtë do të shitet për 44 denarë për litër. Me vendimin rritet edhe çmimi i mazutit, i cili do të arrijë 28.6 denarë për kilogramë. Çmimi mestar i naftës së papërpunuar në tregun botëror në 14-të ditët e fundit arrinte 64 dollarë për barel, ndërsa kursi i dollarit arrinte 52.16 denarë.

Edhe dy ankese për autostradën Kërçovë-Ohër

Shkup, 25 dhjetor - Kompanisë kinëze Sinohidro sipas të gjitha gjasave do t'i propozojmë dy ankese të marrëveshjes për autostradën Kërçovë-Ohër. I pari do të jetë për vazhdim të afatit për ndërtim edhe për tre vite, ndërsa i dyti për shumë plotësuese për ndërtim pa leje, paralajmëroi të hënën ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski. "Për shumë plotësuese ende po negociohet dhe prandaj sipas të gjitha gjasave do të shkohet me dy ankese të marrëveshjes. I pari do të jetë vetëm me vazhdim të afatit dhe sipas të gjitha gjasave do të nënshkruhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm kur skadon afati për ndërtim të autostradës, e më pas do të pasojë aneksi për shumë plotësuese", tha Sugareski, duke u përgjigjur në pyetjet në konferencën e sotme për shtyp në Agjencinë për kadastrë të patundshmërive. Nëse do të ishin të gatshme përlllogaritë, sh-toi, do të shkonim vetëm me një aneks edhe për afatin edhe për shumën. Ai theksoi se nuk është e saktë se shteti u ka para borxh kompanive të cilat punojnë në autostradë. "Është e mundur që ndërmarrjet t'u kenë borxh punëtorëve, por jo edhe shteti ndërmarrjeve", saktësoi Sugareski. Për ndërtimin e autostradës drejt Shqipërisë theksoi se derisa vlerësohet se është në rregull dokumentacioni projektues nuk do të thuhet afatet. "Pa një dokumentacion të mirë projektues vetëm do të nënshkruajmë ankese të marrëveshjeve për ndërtim të rrugëve. Prandaj nuk dëshiroj të konkretizoj datë kur do të fillojë ndërtimi i kësaj rruge dhe rrugës drejt Bllacës.

Zvogëlohen çmimet e shërbimeve të Kadastrës

Shkup, 25 dhjetor - Hynë në fuqi tri tariforet e reja me të cilat prej 20 deri në 90 për qind zvogëlohen çmimet e shërbimeve të cilat i ofron Agjencia për Kadastrën e patundshmërive. "Në tariforen për kompensimin për regjistrimin e objekteve çmimet zvogëlohen mesatarisht për 90 për qind. Në tariforen për regjistrimin e patundshmërive në Kadastrë zvogëlohen në mesatare për 51 për qind, ndërsa çmimet në tariforen për kompensimin për shfrytëzimin e të dhënave prej sistemit gjeodezik - kadastral zvogëlohen mesatarisht për 28 për qind", tha ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski në konferencën e sotme për shtyp. Ai theksoi se me masën për zvogëlimin e çmimeve të



shërbimeve të Kadastrës është plotësuar premtimi i dhënë në programin qeveritar. Për periudhën e ardhshme premtoi sjelljen e ligjit të ri për veprimtari gjeodezike prej Ligjit për Kadastrën e patundshmërive. "Ky ligj është i nevojshëm që të harmonizohemi me rregullativën

evropiane sa i takon vendosjes së datës së re gjeodezike dhe përpunimit të projekcionit të ri kartografik të vendit", tha Sugareski. Drejtori i Agjencisë për Kadastrën e patundshmërive, Boris Tunxhev precizoi se tariforet e reja për shërbimet që i ofrojnë ndaj qytetarëve dhe kom-

panitë janë publikuar në Gazetën Zyrtare. Për regjistrimet e të drejtave në bazë të sendërtimeve dhe legalizimit të objekteve të ndërtuara në mënyrë të jashtëligjshme është zvogëluar për 20 për qind, ndërsa gjithashtu po aq lirohen edhe dokumentet për shënimin për ndërtesat më të mëdha për strehim. Ai theksoi se kompensimi për bujqit është zvogëluar prej 38 deri në 80 për qind. Zvogëlimi i çmimeve të shërbimeve, potenco, nuk do të reflektojë mbi punën e Kadastrës dhe shtoi se me masa të tjera do të zvogëlohen shpenzimet të cilat janë bërë në të kaluarën për më shumë shërbime të cilat nuk kanë qenë në funksion të përmirësimit të punës.

Vetëm 18 për qind e qytetarëve janë të kënaqur nga administrata

Shkup, 25 dhjetor - Vetëm 18 për qind e qytetarëve janë të kënaqur nga shërbimet e administratës publike. Individualisht sipas institucioneve, më të kënaqur janë nga puna e Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjegjësisht nga shërbimet për dhënie të dokumenteve të udhëtimit, ndërsa më pak janë të kënaqur nga puna e qendrave për politikë sociale. Këtë të hënën e theksoi Dijana Zhupanoska nga Qendra për strategji evropiane "Eurothink" duke i prezantuar rezultatet nga hulumtimi, të cilin Qendra e realizoi së bashku me Platformën e Maqedonisë kundër varfërisë, e para e këtij lloji. Hulumtimi u është prezantuar përfaqësuesve të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, ndërsa më tej është planifikuar që të shkojë deri te ministrinë kompetente me qëllim që të theksohen problemet e përmbajtur në të. Zhupanovska theksoi se 63 për qind e qytetarëve konsiderojnë se që të marrin ndonjë shërbim nga administrata publike nevojitet të kenë lidhje.

"E gjithë kjo thekson në raportin ndaj klientëve dhe joqasshmërisë së shërbimeve për të gjithë qytetarët. Kjo është meritë para së gjithash e mungesës së resurseve financiare dhe njerëzore", shton ajo. Momentalisht shteti siguron rreth 150 shërbime publike ndaj qytetarëve. Sipas raportit të Avokatit të Popullit të vitit 2016 të dytë sipas numrit janë parashtrës, të cilat u dedikohen punës së organit kompetent për evidencë amë të qytetarëve, Drejtoria për menaxhim të librave amë, posaçërisht Sektori, që i mbulon rajonet amë për Qytetin e Shkupit dhe komunat e saj. Biljana Dukovska, kryetare e Platformës së Maqedonisë kundër varfërisë, shpjegoi se ky hulumtim është pjesë e aktiviteteve në të cilët tanimë një vit Platforma punon së bashku me Fondin për popullsi të KB-së në sferën e regjistrave të popullatës, me ç'rast ka dalë bashkëpunimi me Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës Publike në drejtim të përpunimit të regjistrat elektronikë të popullsisë. "Raporti locon se problem më i madh kanë ata të cilët janë të paarsimuar ose jo të favorizuar dhe madje ata janë të kufizuar që t'i kërkojnë të drejtat e tyre. Shërbimet shëndetësore ose ajo që u takon si e drejtë në sferën e mbrojtjes sociale janë një prej më kritikëve, për shkak se në këtë kategori më së shpeshti janë kategoritë më të varfra dhe më të rrezikuara", thotë ajo. Bukovska shton se konkluzion i Platformës është se familjet të cilat jetojnë në varfëri nuk dalin nga ajo, por pikërisht kjo bartet edhe tek gjeneratat e tjera.

KULTURA 2018-2022, VAZHDON DEBATI

STRATEGJIA, SHUMË PIKËPYETJE PËR KULTURËN SHQIPTARE

Ky dokument që ende nuk është zyrtar është publikuar në faqen elektronike të ministrisë, ndërsa të mërkurën do të prezantohet në debatin e fundit publik përpara se të marrë miratimin nga Qeveria dhe më pas nga Parlamenti. Sipas anëtarëve shqiptarë të grupit të punës, ky version i fundit, ka shumë paqartësi sa i takon strategjisë konkrete për zhvillimin e kulturës shqiptare në veçanti, por edhe për vetë mënyrën e realizimit të saj

Koha Evis HALILI

Shkup, 25 dhjetor - Ministria e Kulturës ka gati versionin e fundit të Strategjisë për zhvillimin katërvjeçar të kulturës, dokument ky që prej disa muajsh është hartuar dhe ndryshuar nga grupi i punës i ngritur nga ky institucion. Dokumenti, që ende nuk është zyrtar, është publikuar në faqen elektronike të ministrisë, ndërsa të mërkurën do të prezantohet në debatin e fundit publik përpara se të marrë miratimin nga Qeveria dhe më pas nga Parlamenti. Sipas anëtarëve shqiptarë të grupit të punës, ky version i fundit, ka shumë paqartësi sa i takon strategjisë konkrete për zhvillimin e kulturës shqiptare në veçanti, por edhe për vetë mënyrën e realizimit të saj.

Artisti Reshat Ameti thotë se për të qenë më i plotë do të duhet që të paktën të shoqërohet nga një dokument shtesë që do të precizonte metodat për zgjidhjen e problemeve dhe adresimin e tyre më konkret. "Ky version duhet akoma të përmirësohet. Në tërësinë e vet është i hartuar si duhet, por problemi qëndron se i mungon ana praktike e realizimit të vetë përmbajtjes. Për shembull, departizimi dhe normalizimi i kulturës nuk tregohet sesi do të arrihet. Sa i takon kulturës shqiptare aty mungon mënyra e afirmimit të saj, institucionalizimi, por edhe vetë si do të kultivohet ajo në suaza të konceptit qytetar që ofron kjo strategji", thotë Ameti. Një tjetër anëtar, Selam Sulejmani, duke cekur mangësitë e këtij drafti thotë se po angazhohen



RESHAT AMETI

Ky version duhet akoma të përmirësohet. Në tërësinë e vet është i hartuar si duhet, por problemi qëndron se i mungon ana praktike e realizimit të vetë përmbajtjes. Për shembull, departizimi dhe normalizimi i kulturës nuk tregohet sesi do të arrihet. Sa i takon kulturës shqiptare aty mungon mënyra e afirmimit të saj, institucionalizimi, por edhe vetë si do të kultivohet ajo në suaza të konceptit qytetar që ofron kjo strategji

që kultura shqiptare të fitojë statusin e saj që e meriton.

"Kemi prezantuar qëndrimet tona në raport me zhvillimet kulturore në vendin tonë, që priten të realizohen në të ardhmen. Mbetet parësore mbështetja e projekteve kapitale në radhë të parë infrastrukturore, siç janë përfundimi i punimeve në Teatrin Shqiptar të Shkupit, intensifikimi i punimeve në Teatrin dhe Bibliotekën e Tetovës dhe projekte të tjera të rëndësishme për themelimin edhe të institucioneve të reja kulturore. Në pjesën shqiptare ka shumë paqartësi, por kemi reaguar, sidomos te disa propozim-ndryshime siç është rasti me ligjin për muzetë - do gëzojnë statusin lokal, apo qendror po për këtë duhet një konsultim-analizë më e gjerë të përfshihen më shumë institucione, ekspertë", thotë Sulejmani. Vërejtje të ngjashme ndan edhe Dijana Toska, anëtarja tjetër



DIJANA TOSKA

Ne kemi bërë vërejtje dhe që nga fillimi kur na është prezantuar ky dokument. Edhe pse ka shumë përmirësime deri në këtë version të fundit, gjithsesi jam e mendimit se kjo strategji duhet sërish të korrigjohet, në vetvete është shumë e përgjithshme dhe jo konkrete për strategjinë mbi të cilën do të zhvillohet kultura shqiptare, në kuadër të kulturës nacionale, gjatë katër viteve të ardhshme

e këtij grupi pune. Sipas Toskës ka ende shumë ndryshime që do të duhet të pësojë ky draft, në mënyrë që të plotësojë të gjitha kushtet për një zhvillim të barabart të kulturave. "Ne kemi bërë vërejtje dhe që nga fillimi kur na është prezantuar ky dokument. Edhe pse ka shumë përmirësime deri në këtë version të fundit, gjithsesi jam e mendimit se kjo strategji duhet sërish të korrigjohet, në vetvete është shumë e përgjithshme dhe jo konkrete për strategjinë mbi të cilën do të zhvillohet kultura shqiptare, në kuadër të kulturës nacionale, gjatë katër viteve të ardhshme", thotë Toska. Si pajojë e politikave të gabuara gjatë dhjetë viteve të fundit kultura është partizuar dhe robëruar, një sërë aktivitete retrograde kanë krijuar konfuzion sa i takon kuptimit të identitetit kulturor, antagonizmit të indit të shoqërisë, shkatërrimit të kapita-



SELAM SULEJMANI

Mbetet parësore mbështetja e projekteve kapitale në radhë të parë infrastrukturore, siç janë përfundimi i punimeve në Teatrin Shqiptar të Shkupit, intensifikimi i punimeve në Teatrin dhe Bibliotekën e Tetovës dhe projekte të tjera të rëndësishme për themelimin edhe të institucioneve të reja kulturore. Në pjesën shqiptare ka shumë paqartësi, por kemi reaguar, sidomos te disa propozim-ndryshime siç është rasti me ligjin për muzetë

lit kulturor, thuhet në dokument.

"Këto situata të krijuara, kërkojnë që të ndryshohet sistemi i kulturës, profesionalizmi i tij, hapja e tij ndaj pjesëmarrjes së gjerë të qytetarëve dhe njëherazi mbrojtja nga ndikimet negative të politikës. Është e domosdoshme që të vendosen mekanizma efikase të vëzhgimit dhe vlerësimit të politikave dhe arritjeve, si edhe krijimi i një aksesi më kritik dhe historik më i ndërgjegjshëm në kulturë", shkruhet në dokument. Si disa prej ndryshimeve që parajlamërohen në strategjinë e kulturës është kalimi nga multikultura në interkulturë, apo nga kultura me interes nacional në kulturë me interes publik. Ndërsa si hapat e para reformues që priten të ndërmerren janë ato tek institucionet nacionale, një pjesë prej të cilave mund të kthehen në lokale, të tjerat me partneritet publiko-privat, e të tjera.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2016), nenit 59 dhe 60 të Ligjit për arsim të mesëm (Gaz. Zyrtare nr. 30/2016) dhe vendimit të u.d drejtorit të SHMQSH “Cvetan Dimov” – Shkup publikohet

SHPALLJE

Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/18

Mësimi në gjuhën shqipe

- Një mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë maqedonase** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për gjuhë maqedonase.
- Një mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë shqipe** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për gjuhë shqipe.
- Një mësimdhënës të gjuhës angleze** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për gjuhë angleze.
- Një mësimdhënës të sociologjisë** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për sociologji.
- Dy mësimdhënës të matematikës** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për matematikë.
- Dy mësimdhënës të lëndëve ekonomike** me 16 orë mësimore gjegjësisht 32 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 17.219 den. me studime të mbaruara për ekonomi.
- Dy mësimdhënës të lëndëve juridike** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për drejtësi.
- Një mësimdhënës të sociologjisë** me 10 orë mësimore gjegjësisht 20 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 10.762 den. me studime të mbaruara për sociologji.
- Një mësimdhënës të biologjisë** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për biologji;
- Pesë mësimdhënës të lëndëve ekonomike** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për ekonomi.
- Një mësimdhënës të informatikës** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për informatikë
- Një mësimdhënës të filozofisë** - me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar, zëvendësim për punëtorin në pushim të lindjes, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për filozofi.
- Një mësimdhënës të lëndëve ekonomike** me 11 orë mësimore gjegjësisht 22 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 11.836 den. me studime të mbaruara për ekonomi.
- Një mësimdhënës të gjuhës shqipe** - me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar, zëvendësim për mësimdhënësin në pushim mjekësor, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për gjuhës shqipe.
- Një mësimdhënës të historisë** me 6 orë mësimore gjegjësisht 12 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 6.457 den. me studime të mbaruara për histori.
- Një mësimdhënës të правни предмети** me 8 orë mësimore gjegjësisht 16 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 8.609 den. me studime të mbaruara për drejtësi
- Një mësimdhënës të psikologjisë** me 18 orë mësimore gjegjësisht 36 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 19.371 den. me studime të mbaruara për psikologji
- Një mësimdhënës të gjuhës latine** me 8 orë mësimore gjegjësisht 16 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 8.609 den, filolog i diplomuar i gjuhëve klasike

Shpallja nr. 03/2017

IPKÇF “Detska Radost” – Strumicë publikon shpallje publike për punësim të gjithsej 10 (dhjetë) realizuesve për kohë të pacaktuar të punës

- I.1 Titulli i vendit të punës:** Edukator për qëndrim të fëmijëve të moshës prej 2 deri 6 vjet – 7 (shtatë) realizues
- 2. Kushtet e përgjithshme:**
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
 - të jetë i moshës së rritur;
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.
- 3. Kushtet e posaçme:**
- profesor i diplomuar për arsim parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijët e moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim të mbaruar sipër të shkallës VII/1 ose arsim të lartë të mbaruar për edukator,
 - licencë valide për edukator dhe
 - me ose pa përvojë pune
- 4. Orari i kohës së punës:**
- ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte;
 - orë të punës në javë: 40;
 - orari i punës me ndërrime:
- Ndërrimi i I prej ora 07:00 deri në ora 15:00
Ndërrimi i II prej ora 09:30 deri në ora 17:30
- 5. Neto pagesa bazë:** 19.426,00 denarë
- 6. Afati për paraqitje:** 10 (dhjetë) ditë pune
- 7. Afati në të cilin duhet të realizohet zgjedhja:** 5 ditë pune.
- 8. Aplikacionet të dorëzohen deri në:** IPKÇF “Detska Radost”, rr. “Mladinska” nr. 1, tel. 034/323-975, personi për kontakt: Tinka Markova.
- 9. Kandidatët që nuk janë zgjedhur do të informohen në afat prej 5 ditëve të punës, pas çka kanë të drejtë për ankesë në afat prej 8 ditë deri në Këshillin drejtues të IPKÇF “Detska Radost” – Strumicë.**

- II.1. Titulli i vendit të punës:** Logoped i diplomuar – 1 (një) realizues
- 2. Kushtet e përgjithshme:**
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
 - të jetë i moshës së rritur;
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.
- 3. Kushtet e posaçme:**
- Arsim sipër 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit (logopedi)
 - licencë valide për punëtor profesional dhe
 - me ose pa përvojë pune
- 4. Orari i kohës së punës:**
- ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte;
 - orë të punës në javë: 40;
 - orari i punës prej ora 08:00 deri në ora 16:00.
- 5. Neto pagesa bazë:** 19.998,00 denarë
- 6. Afati për paraqitje:** 10 (dhjetë) ditë pune
- 7. Afati në të cilin duhet të realizohet zgjedhja:** 5 ditë pune.
- 8. Aplikacionet të dorëzohen deri në:** IPKÇF “Detska Radost”, rr. “Mladinska” nr. 1, tel. 034/323-975, personi për kontakt: Tinka Markova.
- 9. Kandidatët që nuk janë zgjedhur do të informohen në afat prej 5 ditëve të punës, pas çka kanë të drejtë për ankesë në afat prej 8 ditë deri në Këshillin drejtues të IPKÇF “Detska Radost” – Strumicë.**

- III.1 Titulli i vendit të punës:** Pedagog i diplomuar për edukatë fizike – 1 (një) realizues
- 2. Kushtet e përgjithshme:**
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
 - të jetë i moshës së rritur;
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.
- 3. Kushtet e posaçme:**
- Arsim sipër 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit, Fakulteti i edukatës fizike
 - licencë valide për punëtor profesional dhe
 - me ose pa përvojë pune
- 4. Orari i kohës së punës:**
- ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte;
 - orë të punës në javë: 40;
 - orari i punës prej ora 08:00 deri në ora 16:00
- 5. Neto pagesa bazë:** 19.998,00 denarë
- 6. Afati për paraqitje:** 10 (dhjetë) ditë pune
- 7. Afati në të cilin duhet të realizohet zgjedhja:** 5 ditë pune.
- 8. Aplikacionet të dorëzohen deri në:** IPKÇF “Detska Radost”, rr. “Mladinska” nr. 1, tel. 034/323-975, personi për kontakt: Tinka Markova.
- 9. Kandidatët që nuk janë zgjedhur do të informohen në afat prej 5 ditëve të punës, pas çka kanë të drejtë për ankesë në afat prej 8 ditë deri në Këshillin drejtues të IPKÇF “Detska Radost” – Strumicë.**

- IV.1 Titulli i vendit të punës:** Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë angleze – 1 (një) realizues
- 2. Kushtet e përgjithshme:**
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
 - të jetë i moshës së rritur;
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.
- 3. Kushtet e posaçme:**
- Arsim sipër 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit, Shkenca për gjuhë – Linguistikë;
 - licencë valide për punëtor profesional dhe
 - me ose pa përvojë pune
- 4. Orari i kohës së punës:**
- ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte;
 - orë të punës në javë: 40;
 - orari i punës prej ora 08:00 deri në ora 16:00
- 5. Neto pagesa bazë:** 19.998,00 denarë
- 6. Afati për paraqitje:** 10 (dhjetë) ditë pune
- 7. Afati në të cilin duhet të realizohet zgjedhja:** 5 ditë pune.
- 8. Aplikacionet të dorëzohen deri në:** IPKÇF “Detska Radost”, rr. “Mladinska” nr. 1, tel. 034/323-975, personi për kontakt: Tinka Markova.
- 9. Kandidatët që nuk janë zgjedhur do të informohen në afat prej 5 ditëve të punës, pas çka kanë të drejtë për ankesë në afat prej 8 ditë deri në Këshillin drejtues të IPKÇF “Detska Radost” – Strumicë.**

IPKÇF “Detska Radost” – Strumicë
Drejtor
Tinka Markova

- 19. Një mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë shqipe** me 15 orë mësimore gjegjësisht 30 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 16.143 den. me studime të mbaruara për gjuhë shqipe
- 20. Një mësimdhënës të sportit dhe aktiviteteve sportive** me 10 orë mësimore gjegjësisht 20 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 10.762 den. me studime të mbaruara për sport
- 21. Tre mësimdhënës të mësimin praktik për profilin arsimor motër medicinale** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për mjekësi – infermieri
- 22. Dy mësimdhënës të grupit të lëndëve të medicinës** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për medicinë
- 23. Një mësimdhënës të grupit të lëndëve të stomatologjisë** me 10 orë mësimore gjegjësisht 20 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 10.762 den. me studime të mbaruara për medicinë
- 24. Një mësimdhënës të grupit të lëndëve të farmacisë** me 15 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 16.140 den. me studime të mbaruara për medicinë – farmaci
- 25. Një mësimdhënës të mësimin praktik në profilin arsimor – teknik i dhëmbëve** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për medicinë – stomatologji
- 26. Një bashkëpunëtor profesional për mësimin praktik të profilit arsimor** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për medicinë – stomatologji
- 27. Një mësimdhënës të mësimin praktik në profilin arsimor teknik i dhëmbëve** me 10 orë mësimore gjegjësisht 20 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 10.762 den. me studime të mbaruara për medicinë – stomatologji

Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/18

Për mësimin në gjuhën turke

- 28. Dy mësimdhënës të lëndëve ekonomike** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për ekonomi
- 29. Një mësimdhënës të matematikës** me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den. me studime të mbaruara për matematikë
- 30. Një bibliotekist** me 40 orë punë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me neto pagesë fillestare 21.522 den., orari i punës prej ora 8 deri në ora 16 me arsim të mbaruar sipëror.
- Orari i punëve të mësimdhënësve është me ndërrime edhe atë: ndërrimi i parë fillon në ora 7,30, ndërsa ndërrimi i dytë është në ora 13,30 ndërsa përfundon në pajtim me orarin e orëve
- DOKUMENTET E NEVOJSHME
- lutje me CV
 - diplomë për arsim përkatës të mbaruar
 - certifikatë të shtetësisë
- Kandidatët për vendet e punës me numër rendor 6, 7, 10, 13, 16, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28 të dorëzojnë edhe certifikatë për derikualifikim pedagogjik – psikologjik dhe metodik
- Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit ndërsa zgjedhja do të bëhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.
- Dokumentet të dorëzohen në SHMQSH “Cvetan Dimov” – Shkup, rr. “Xhon Kenedi” nr. 16
Tel: 02/2611-530

SHMQSH “Cvetan Dimov” – Shkup
u.d Drejtor,
Mustafa Allii

Në bazë të nenit 68 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe nenit 5 të Ligjit për revizion shtetëror (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/10, 145/10, 12/14, 43/14, 154/15, 192/15 dhe 27/16) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur më 22 dhjetor 2017, ka sjellë

VENDIM PËR PUBLIKIM TË SHPALLJES PUBLIKE PËR ZGJEDHJE TË REVIZORIT KRYESOR SHTETËROR TË ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION

- I. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë publikon shpallje publike për zgjedhje të revizorit kryesor shtetëror të Entit shtetëror për revizion.
- II. Për revizor kryesor shtetëror të Entit shtetëror për revizion mund të zgjidhet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:
- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - 2) të ketë arsim sipëror nga sfera e shkencave ekonomike ose juridike;
 - 3) të ketë së paku shtatë vjet përvojë nga sfera e ekonomisë ose drejtësisë;
 - 4) posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht në vijim ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS – së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
 - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë ose
 - BULATS – së paku 60 pikë.
 - 5) ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet;
 - 6) të mos kryejë funksion ose profesion tjetër publik, të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike, anëtar i ndonjë këshilli drejtues, këshilli mbikëqyrës ose cilitdo organ tjetër tek ndonjë subjekt tjetër juridik dhe
 - 7) të mos i jetë shqiptuar sanksion për kundërvajtje, gjegjësisht dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- III. Fletëparaqitja për pjesëmarrje në këtë shpallje, biografia personale dhe dokumentet e nevojshme për dëshmi të përmbushjes së kushteve nga pika II e këtij vendimi, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, kandidatët e interesuar duhet t'i parashirojnë në Kuvendi e Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të këtij vendimi në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.
- Kandidatët e interesuar, me dokumentet nga paragrafi 1 e kësaj pike duhet të parashirojnë edhe deklaratë personale të vërtetuar në noter për përmbushje të nënpikës 6) të pikës II të këtij vendimi.

IV. Ky vendim do të publikohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” dhe në gazetata ditore “Nova Makedonija”, “Sloboden Peçat”, dhe “Koha”.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Numër 08 - 4794/1
22 dhjetor 2017
Shkup

KRYETARI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË
m-r Talat Xhaferi, d.v

Se dokumenti është i besueshëm me origjinalin konfirmon:

ZËVENDËSSEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
Nexhbetin Ibraimi

Edhe përkundër dëshirës së madhe të shumë qytetarëve dhe ofertave të shumta dhe të volitshme që ofrojnë agjencitë turistike për të kaluar pushimet dimërore jashtë vendit, megjithatë për një pjesë të madhe kjo mbetet e porealizueshme për shkak të kushteve të vështira ekonomike

NË PRAG TË FESTAVE TË FUNDVITIT

PUSHIMET DIMËRORE, SHUMË OFERTA DHE PAK MUNDËSI



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 25 dhjetor - Banjsko në Bullgari, Antalia në Turqi, Vjena e Austrisë, Dubai edhe këtë vit janë top destinacionet që ofrojnë agjencitë turistike në Tetovë për qytetarët që duan të kalojnë pushimet dimërore dhe festat e fundvitit.

Ofrohen aranzhmane të ndryshme me fluturime charter, akomodime në hotele me përfshirjen e qendrave e qendrave turistike të skijimit në shumë vende të Evropës, megjithatë, agjencitë turistike thonë se aranzhmanet për në Bansko dhe Antalia janë më shumë të kërkuara, pas çka vijnë ofertat edhe për në Vjenë të Austrisë, Dubai dhe Venecia të Italisë. "Si çdo vit, edhe këtë vit ne si tour-operator turistik ofrojmë oferta

për pushimet dimërore si dhe oferta për të festuar festat e fundvitit. Si risi këtë vit kemi Antalinë për ku kemi fluturim direkt me charter, ndërsa në paketë përfshihet edhe hoteli, pastaj si destinacion ofrojmë edhe Vjenën, Sofjen për 59 euro për person, e kemi poashtu edhe Shqipërinë si dhe Dubain që është pak më shtrenjtë se destinacionet tjera, gjegjësisht 999 euro për person. Interesimi edhe këtë vit është në nivel, ndërsa për në Antali kërkesat janë më të shumta", thotë Albana Bislimi, nga agjencia turistike "Europ Turist". Nga "Arsimi Company" thonë se

kanë shumë oferta për këtë fundvit. "Tash si janë këto festat e fundvitit ne si agjenci turistike njëjtë sikurse agjencitë e tjera kemi përgatitur ofertat për fundvit. Si destinacion kryesore e kemi Antalinë, Banjskon... Në këtë ofertë përfshihen festat e fundvitit, aranzhmani është paketë dhe organizohet prej Shkupi dhe prej Prishtinës në bashkëpunim me dy kompanitë kryesore 'Fibula' dhe 'VasTour', ndërsa ne si përfaqësues të kësaj agjenci i kemi ofertat më kryesore dhe me çmime shumë më të volitshme. Në ofertë përfshihet fluturimi, transporti nga Te-

tova deri në aeroport, tikitat e udhëtimit, aranzhmani i brendshëm domethënë hoteli, dhe gjithashtu nata e vitit të ri që organizohet në vendet për ku edhe udhëtohet", tha Artan Nuredini nga "Arsimi Company".

Nga ana tjetër, qytetarët thonë se për të kaluar një pjesë të pushimeve dimërore - do të zgjedhin një nga qendrat turistike të vendit qoftë Kodrën e Diellit, apo qendrën turistike dimërore të Mavrovës, ndërsa festat e fundvitit si zakonisht do ti kalojnë në familje ose në ndonjë nga restorantet e vendit për shkak të ardhjes edhe të fa-

miljarëve të tyre që jetojnë dhe punojnë përkohësisht jashtë vendit. "Kemi vendos që fundvitin ta kalojmë në qytetin e Tetovës, dëshira është e madhe për të udhëtuar, por mundësitë ekonomike nuk lejojnë, prandaj do të festojmë në Tetovë", thotë Afrimi, një qytetar i Tetovës. Përndryshe, edhe përkundër dëshirës së madhe të shumë qytetarëve dhe ofertave të shumta dhe të volitshme që ofrojnë agjencitë turistike për të kaluar pushimet dimërore jashtë vendit, megjithatë për një pjesë të madhe kjo mbetet e porealizueshme për shkak të kushteve të vështira ekonomike.

Publicitet

Rijani ngjit "Gratë" në skenën e Teatrit Shqiptar



Shkup, 25 dhjetor - Me një homazh për gruan Teatri Shqiptar e mbyll këtë vit. Është shfaqja "Gratë", sipas veprës së shkruar nga dramaturgu Robert Thomas (Tetë gratë) premiera e së cilës do të shfaqet të martën në Teatrin e Komedisë. Regjisori i shfaqjes, Qëndrim Rijani, ka vendosur që të ngjisë në skenën shqiptare një vepër që është dramaturg dhe ekranizuar me sukses në botë, përmes një kaste të zgjedhur aktorësh si Teuta Ajdini-Jegeni, Drita Kaba Karaga, Amernis Nokshiqi, Vjollca Bekteshi Hamiti, Alida Alidemi, Zarije Jonuzi Çeliku, Mirlinda Saiti dhe Aida Elezi. Skenografia e shfaqjes është realizuar nga Petrit Bakalli, muzika nga Fatos Lumani dhe komstumografia nga Marja Papuçevska. Kështu ai premton të realizojë një tjetër

shfaqje të suksesshme, përmes elementeve dhe gjetjeve të reja në realizimin e "Grave", një komedi që fshikullon botën ku janë të detyruara të jetojnë gratë dhe problemet e vetë shoqërisë maskiliste. Fabula e kësaj komedie të zezë, shkruar gati 60 vjet më parë, vazhdon të jetë sa intriguese po aq edhe aktuale. Tetë gra që janë mbledhur së bashku për të festuar festat e fundvitit gjenden papritur të kapura të grackë, sa nga bora që nuk i lë të dalin jashtë, po aq sa edhe misteri i një vrasjeje, kur zbulojnë mashkulli i vetëm në atë shtëpi është vrasë me një thikë mbas shpine. Të gjitha janë të detyruara të rrinë bashkë dhe të dyshuara për vrasjen. Secila prej tyre ka një sekret, por edhe motiv për ta kryer vrasjen. "Gratë", kombinojnë së bashkë farsën, melodramën, muzikën dhe misterin e një vrasjeje, por aq sa edhe adresojnë aktin, lakminë, shkeljen e kurorës dhe homoseksualitetin. "Tetë gratë" është një vepër e shkruar nga Thomas në vitin 1958, në periudhën kur ai përpiquej që të shpikte një zhanër të ri, komedinë policore, apo komedinë triler. Premiera e parë është dhënë me sukses në Paris (1961) ku mori edhe çmimin "Quai des Orfèvres". Po ashtu kjo vepër është ekranizuar dy herë, në vitin 1960 me titullin "Nata e të dyshuarve", si edhe dhe në vitin 2002 (Tetë Gra). Kjo vepër në vite është nominuar me shumë çmime, si ato "Çezar", çmimet evropiane të filmit, e të tjera. (E.H)



IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR KARDIOLOGJI

Vodnjanska 17, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
tel. +389 2 3113-116 faks: +389 2 3164-134

Në bazë të nenit 157 paragrafi 1 alineja 1, nenit 158 paragrafi 1, 2, 5 dhe 6, nenit 159 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore – tekst i pastruar ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12...37/2016, si dhe lajmërimet nga Ministria e financave numër 18-13053/2 të datës 18.12.2017, IP SH Klinika Universitare për kardiologji – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të punëtorit shëndetësor për kohë të pacaktuar

1 (një) realizues Doktor i medicinës – mjek shkalla VII/1 PSP – fakulteti i medicinës, pa përvojë pune

Kushtet e përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
- të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme duhet të përmbushin edhe

Kushtet e posaçme:

- të ketë arsim sipëror të mbaruar shkalla VII/1 PSP Fakulteti sipëror
- certifikatë për provim të dhënë profesional,
- licencë për punë,
- njohje të 1 (një) prej gjuhëve të huaja,

Të bashkëngjitur me Fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrorin edhe dokumentet në vijim:

- biografi të shkurtë - CV,
- certifikatë të shtetësisë, jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj,
- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj,
- dëshmi se nuk është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- certifikatë për arsim të mbaruar,
- certifikatë për provim të dhënë profesional,
- licencë për punë,
- dëshmi për njohje të një prej gjuhëve të huaja (angleze, gjermane, frënge)

Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.

Zgjedhja e kandidatit do të realizohet në pajtim me nenin 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12...37/2016)

Përparsi për zgjedhje të kandidatit do të kenë licencë të angazhuar me marrëveshje në vepër në pajtim me nenin 9 nga Ligji për transformim në marrëdhënie të rregullt të punës (Gazeta Zyrtare e RM nr. 20/15).

Fletëparaqitjet me dokumentet e parashtruar të pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme (në original ose kopje të vërtetuara në noter) mund të parashtrohen personalisht në arkivin e IP SH Klinika Universitare për kardiologji – Shkup ose përmes postës në adresën: IP SH Klinika Universitare për kardiologji – Shkup – rr. Vodnjanska nr. 17, 1000 Shkup.

IPSH Klinika universitare për kardiologji

Kushti i dytë!

Nga Augustin PALOKAJ



Bashkimi Evropian ka bërë një padrejtësi ndaj Kosovës pas një padrejtësie më të hershme. E ka bllokuar procesin e liberalizimit të vizave në pritje të ratifikimit të Marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi. Ka mundur BE-ja të nisë dhe të përfundojë procesin, siç në fakt edhe ishte rekomandimi i Komisionit Evropian nga viti 2015, e pastaj të presë ratifikimin deri në datën e hyrjes në fuqi të liberalizimit të vizave. Vetëm në këtë mënyrë kosovarët do të ishin të sigurt se me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje do të fitojnë liberalizimi i vizave. Ka qenë e padrejtë që fare të përmendet ratifikimi si kusht, pasi që demarkacioni i kufirit nuk ka qenë kusht për asnjë shtet tjetër për asgjë. Por pas kësaj padrejtësie ka qenë e padrejtë edhe lëvizja e këtij kushti nga "para hyrjes në fuqi të liberalizimit" me kusht për të nisur procedurat në BE. Prandaj, për liberalizimin e vizave me Kosovën procedura në Këshill dhe Parlament Evropian do të nisë vetëm pasi të përmbushet ky kusht, e jo të përfundojë shumë para përmbushjes së kushtit duke e kushtëzuar afatin e përmbushjes me hyrjen në fuqi të liberalizimit. Pra, tash Kosova është në një situatë në të cilën, nëse përmbushet kushti, nuk ndodh liberalizimi, por nis procedura. E ajo procedurë mund të përmbillet për gjashtë muaj apo për më shumë. Ajo procedurë mund edhe të ngejë gjatë rrugës, duke u përballur me pengesa të tjera. Kjo është edhe një vërejtje për të gjithë ata në Kosovë, të cilët, edhe pse kanë pasur shumë shembuj se si nuk bënë të garantohen data, vazhdojnë të japin premtime për afate se kur mund të ndodhë liberalizimi i vizave.

Dhe, siç e thotë gjithmonë BE-ja, siç kanë tërhequr vërejtjen edhe mediat e edhe shoqëria civile e ekspertët, Kosova nuk e ka kusht vetëm ratifikimin e demarkacionit, por ka edhe kushtin e dytë, atë të luftës së suksesshme kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivel të lartë. Për këtë BE-ja do të shohë dëshmi konkrete. Madje ka të tillë që mendojnë se ndoshta në Kosovë mungon vullneti për ta përmbushur kushtin e parë, sepse atëherë do të bëhet presion për të përmbushur kushtin e dytë. E kushti i dytë nuk do të mundë të dëshmohej si i përmbushur pa parë zyrtarë të lartë, të lidhur me krimin e organizuar, në burg dhe pasurinë e tyre të konfiskuar. A ka apo jo Koso-

va, me këta prokurorë dhe gjykatës, vullnet dhe guxim për ta përmbushur këtë kusht nuk mund ta dimë pa e parë me sytë tanë. Disa diplomatë në BE pohojnë se Kosova ka ngecje të madhe në dhënien e rezultateve për luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, që e bën kushtin e ratifikimit të Marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi ndoshta edhe më të lehtë se kushtin e dytë. Përderisa për kushtin e parë do të mjaftonte vullneti politik, për të dytin duhen rezultate konkrete nga ana e prokurorëve, gjykatësve, policisë e këtu Kosova nuk i ka punët mirë, e as EULEX-i nuk i ka ndihmuar. Por BE-ja nuk do të kërkojë llogari nga EULEX-i. Prandaj, edhe kushti i dytë mund të jetë ndoshta edhe më i vështirë se i pari. Në një dokument të BE-së, që e kishte siguruar "Koha Ditore", e i cili ishte përgatitur në formën e "qëndrimeve të përbashkëta të BE-së për takimin e Këshillit të MSA-së me Kosovën" shihet qartë se çfarë mendojnë në BE për situatën në Kosovë, sa i përket luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, e që lidhet me efikasitetin dhe pavarësinë e gjyqësorit.

Shqetësimi kryesor i Bashkimit Evropian me Kosovën janë krimi i organizuar dhe korrupsioni, me të cilat lidhet edhe çështja e respektimit të ndarjes së pushteteve, influenza politike dhe humbja e besimit në sistemin gjyqësor, mosrespektimi i

Disa diplomatë në BE pohojnë se Kosova ka ngecje aq të madhe në dhënien e rezultateve për luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar sa që edhe po ta përmbushë kushtin e ratifikimit të Marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi mund të mos e realizojë qëllimin e liberalizimit të vizave. Përderisa për kushtin e parë do të mjaftonte vullneti politik, për të dytin duhen rezultate konkrete nga ana e prokurorëve, gjykatësve, policisë, e këtu Kosova nuk i ka punët mirë e as EULEX-i nuk i ka ndihmuar. Por BE-ja nuk do të kërkojë llogari nga EULEX-i. Prandaj, edhe kushti i dytë mund të jetë ndoshta edhe më i vështirë se i pari



plotë i procedurave në emërimet e prokurorëve dhe gjykatësve, e besa edhe shqetësimet për privilegje të personave të burgosur që janë „të profilit të lartë“. Shqetësimet kryesore të BE-së rreth Kosovës kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, që është prioritet edhe në kuadër të agjendës së reformave evropiane. BE-ja nënvizon rëndësinë e gjyqësorit të pavarur, respektimin e ndarjes së pushteteve dhe një proces transparent, i cili do të rikthente besimin e opinionit vendor dhe ndërkombëtar në sistemin gjyqësor. BE-ja shpreh shqetësim për mosrespektimin e plotë të procedurave gjatë emërimeve të fundit të presidentëve të gjykatave dhe gjykatësve. BE-ja kërkon edhe veprime për të parandaluar çfarëdo forme të trajtimit të privilegjuar të të burgosurve të nivelit të lartë. BE-ja madje është e mendimit se në Kosovë mungon përkushtimi strategjik politik, gjë që, krahas ndërhyrjeve të panevojshme pengojnë luftën kundër krimit të organizuar.

Por disa zyrtarë të Kosovës në të kaluarën mundoheshin të bindin opinionin se si kusht ka mbetur vetëm ratifikimi i Marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi, ndërsa kushti tjetër ishte përmbushur. Madje thoshin se për këtë "garanci" u kishte dhënë personalisht "zonja Mogherini". Tash në BE thonë se "asnjëherë askush nga BE-ja në mënyrë zyrtare nuk ka thënë se

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhesh, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 25 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
 Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndhimskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
 E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
 Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

NË SHIRITIN E KOHËS

Tirana, jetë Stambolli

Nga Petro MARKO



është përmbushur kushti i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit". Tash në BE sqarojnë se diku në pranverë zyrtarë të saj kishin lavdëruar Kosovën për atë që e kishin konsideruar si "progres të madh në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit", dhe tërheqin vërejtjen se pohimet e tilla duhet lexuar me kujdes dhe fjalën "progres" nuk duhet zëvendësuar me "përmbushje të kushtit", sepse shpesh as progresi i madh nuk do të thotë se kushti është përmbushur në tërësi. Ndërkohë tash thonë se, përderisa në pranverë Kosova vërtet nisi të shënojë progres, duke pasur disa raste të reja të hetimeve dhe ngritjeve të aktakuzave. Prandaj, edhe në BE u vlerësua se, nëse vazhdon kështu, ky kusht do të mundë të përmbushet për një afat të kënaqshëm që do ta bënte të mundshëm liberalizimin nëse përmbushet edhe kushti i kufirit me Malin e Zi. Por prej atij momenti, thonë burimet tona në Bruksel, progresi në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, sidomos të atij të lidhur me strukturat politike, pothuajse u ndal apo së paku u ngadalësua. Nuk pati procese të nivelit të lartë gjyqësor e as vendime të plotfuqishme të gjykatare për raste të "profilit të lartë". E pa vendime të tilla pak kush do të bindet se Kosova e ka seriozisht kur premtion luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivelin e lartë. Prandaj, Kosova nëse vërtet do që ta sigurojë liberalizimin e vizave, nëse vërtet do të krijojë vullnet për të ratifikuar Marrëveshjen me Malin e Zi, e cila, e dëmshme apo jo, e drejtë apo jo, e mirë apo e keqe, më nuk mund të ndryshohet, duhet të jetë e kujdesshme që të sigurojë edhe përmbushjen e kushtit të dytë të cilin, edhe nëse e kanë haruar në Prishtinë, në Bruksel e kryeqytete të tjera evropiane nuk e kanë haruar. Sikur nuk po i ndihmon Kosovës arsyetimi se askush tjetër nuk e ka pasur si kusht demarkacionin për liberalizim vizash, nuk do t'i ndihmojë as fakti se ka edhe vende të tjera të rajonit që janë të korrupsionit, por qytetarët e tyre kanë liri të lëvizjes pa viza. (koha.net)

- Hajde Paçe Stambolli!
- Hallvë Stambolli!
- Këpucë Stambolli!
- Rroba, jorgane Stambolli!
- ...Stambolli!

Vetëm xhizë Tirone. Xhizë, kajmak...

Stambolli është emër që i jep reklamë plaçkës që shitet. Sadoqë bathët ose bizelet ose mishi i mirë, që mban Sotir Apostoli janë mall i vendit, prapë ai do të thotë:

- Mall Stambolli zotëni!

Dhe sado që stofa japoneze ka sunduar dyqanin e Hysen Ali Mehmetit, të cilin e vizitojnë dita-ditës qindra katundarë ai u bërtet:

- Merrni mall Stambolli! Mall i lirë, i lirë...

Dhe Lame Murthi, kur u servir hallexhinjëve kafet e tij plot kajmak, u thotë:

- Vallahi, pini mall Stambolli.

Mirëpo njerëzit, po jeta? A bien erë Stambolli vendet e dëfrimit ose vatrat e hallexhinjëve? Se kryeqyteti ynë është i ri, siç është edhe mosha jonë e re. Tirana është 17-vjeçare. Të gjithë si një vajzë 17-vjeçare, e cila fundi i fundit ka ëndrra, shpresë, shqetësime. Dhe siç mund të gjejë njeriu brenda shpirtit të një vajze aq të re botëra të ndryshme, sidomos mendje të papjekur dhe çrregullim në jetë, kështu mund të vërehet edhe këtu.

-Ane ku ka qenë një herë Tirana! Dhe si u bë sot? Dhe në daç të shohësh Tiranën e dikurshme, futu mu në kërkim të saj, atje ku çdo gjë vazhdon rrugën e dikurshme. As rrugët, as

Stambolli është emër që i jep reklamë plaçkës që shitet. Sadoqë bathët ose bizelet ose mishi i mirë, që mban Sotir Apostoli janë mall i vendit, prapë ai do të thotë: Mall Stambolli zotëni!

dyqanet, asgjë s'ka ndryshuar. Vazhdojnë pak nga pak evolutën bashkë me jetën e banorëve të tyre.

A e keni vënë re? Tri rrugë kryesore rrethojnë si mure mongoljane Tiranën e vjetër. Atje brenda qytetërimi s'ka guxuar të depërtojë. Sa larg është, bie fjala, sheshi i ministrive nga tregu i vjetër!

As 100 metra nuk janë larg sheshit, por më tepër se 100 shekuj janë prapa!

Megjithatë, atje gjëmon "Stambolli". Salepçinj, hallvaxhinj, qelshexhinj, jorganaxhinj, e ku ta di unë turliturlit farkëtarësh, teneçexhinj, kallajxhinj... atje brenda kanë formuar një jetë më vete dhe s'duan të dinë fare se ç'ngjet përjashta tyre.

Atje, p.sh., Beqiri prej Shkodre, rrobaqepës me nam, vazhdon të qepë ende një xhakëtë vetëm për një lek e gjysmë dhe kostumin e tërë për një dy lekë. Dy lekë vetëm. Dhe në një orë e sipër fshatari që shiti drutë e ka kostumin gati. Ndryshon puna se si u qep. Puna është që jabanxhiu e bëri kostumin. Ai s'vë re nëse njëra mëngë është një pëllëmbë më e shkurtër se tjetra. Dhe kur thotë:

-More usta, pse...

Atëherë Beqiri bërtet:

-Mall Stambolli aga!

Jo vetëm ata kanë punuar në Stambolli dhe që kanë ardhur këtu e ushtrojnë mjeshtëritë e tyre për mendin me mall qytetin e ëndrrave dhe të qejfeve, po edhe ata të tjerët që s'ia kanë parë kurrë madhësinë e tij, kur duan të çfrejnë ose të tregojnë diçka e

zënë në gojë, ndonëse pa dashje, Stambollin. Kam parë shumë njerëz të mirë e për të qenë, të veshur shik, që banojnë në pallate të mira e moderne, që kur venë në "Nacional" e ja shtrojnë me birra, bëhen tapë, dhe atëherë harrojnë fare se ç'janë, paraqiten ata që janë në të vërtetë, marrin karroca dhe shpejt për në kafe "Vera", atje ku gjëmon defi si në Stambolli, atje ku dëfren njeriu si në afenget e dikurshme të Konstandinopolit.

Se, fundi i fundit, ku do të vejë njeriu të argëtojë? Ku do të kalojë ndonjë orë i dehur në mes të qejfeve të ndryshme? S'ka lokale dëfrimi. S'ka jetë. Ditë e natë në kafene. Ja në "Kristal", ja në "Kursal", ja në "London", në "Berlin", në "Bella Venezia". Ose tek Loni i shkretëtë, që i ra në supë duke kënduar gazetë... E pastaj shpejt tek z. Vasil Avrami, jo te deputeti, por te farmacisti i mirë, që të pret gjithnjë me buzëqeshje dhe që të shërben me shpejtësi... një aspirinë, se të zuri koka! Dhe në të dalë prej tij, nga e djathta, dëgjon një zë:

-Hajde hallvë Stambolli, zotëni!

Aspirinë apo hallvë! Ç'të pëlqen? Ç'të shëron?

E vërteta është se çdo shqiptar që ka punuar në Stambolli, kur është kthyer në atdhe, vetëm këtu në Tiranë ka gjetur vend. Dhe sheh këtu berberët më të mirë, gjellëtoret, rrobaqepësit, kasapët, këpucarët më të mirë, që përipiqen t'i kënaqin myshterinjtë duke u treguar dhe punët e mira fitimprurëse të Stambollit.

(Botuar më 1937)



Në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të EVN Maqedoni SHA – Shkup
për shitje të pronës së patundshme nr. 02-4318/2-9
të datës 20.12.2017 dhe 02-4318/2-10 të datës 20.12.2017

THIRRJE PUBLIKE nr. 4-1/2017

Për shitje të pronës së patundshme (truall dhe objekte)

1. Pronë e patundshme në Peshanë:

A/ Objekt dhe truall të PK nr.719 KK Peshanë

- ndërtesa 1, kati bodrum, hyrja 1 PP me sipërfaqe të përgjithshme prej 157 m²,
- ndërtesa 1, kati përdhësë, hyrja 1 BN me sipërfaqe të përgjithshme prej 173 m²,
- ndërtesa 1, kati 1, hyrja 1 BN me sipërfaqe të përgjithshme prej 172 m²,
- ndërtesa 1, kati përdhësë, hyrja 1 PZ me sipërfaqe të përgjithshme prej 12 m²,
- ZPZ 1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 233 m²,
- ZPZ 2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 18 m²,
- TN me sipërfaqe të përgjithshme prej 1.473 m²,

të evidentuar në FP nr. 2017, KK Peshanë.

B/ Objekt dhe truall në PK nr. 817 KK Peshanë

- ndërtesa 1, kati bodrum, hyrja 1 PP me sipërfaqe të përgjithshme prej 157 m²,
- ndërtesa 1, kati përdhësë, hyrja 1 PP me sipërfaqe të përgjithshme prej 172 m²,
- ndërtesa 1, kati 1, hyrja 1 PP me sipërfaqe të përgjithshme prej 172 m²,
- ZPZ 1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 178 m²,
- TN me sipërfaqe të përgjithshme prej 1.123 m²,

të evidentuar në FP nr. 207, KK Peshanë.

C/ Truall në PK 717, KK Peshanë

- TN me sipërfaqe të përgjithshme prej 717 m²,

të evidentuar në FP nr. 207, KK Peshanë.

Çmimi fillestar i pronës së patundshme me numër rendor 1 (pikat A, B dhe C) është 48.185,00 EUR në vlerë të denarit.

2. Pronë e patundshme në Sveti Nikollë:

- truall i pandërtuar PK nr. 10747/2, KK Sveti Nikollë GR, vendi i quajtur Rudina, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3.566 m² e evidentuar në FP nr. 4 me çmim fillestar prej 35.660.00 EUR në vlerë të denarit.

Të drejtë të blerjes kanë të gjithë personat e interesuar juridikë dhe fizikë.

1. Çdo ofertues mund të dorëzojë vetëm një ofertë.
2. Mjetet themelore – patundshmëritë, lëndë të kësaj thirrje shiten sipas principit “E parë e blerë” pa të drejtë në ankesë.
3. Për mjetet themelore – pronë e patundshme, lëndë e kësaj thirrjeje, mund të realizohet kqyrje nëpërmjet personit Ilija Kiroski dhe të njëjtat të shihen me ndërmjetësim të EQK Shtip, dhe EQK Ohër në periudhën prej 26.12.2017 deri më 10.01.2018, çdo ditë pune prej orës 10 deri në orën 14.
Qasja në dokumentacion për pronën e patundshme që është lëndë e kësaj thirrjeje mund të realizohet tek personi Ilija Kiroski në drejtorinë e EVN Maqedoni SHA Shkup, rr. “11 Tetori” nr.9, në periudhë prej 26.12.2017 deri më 10.01.2018, çdo ditë pune prej orës 10 deri në orën 14.
4. Ofertat të dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim: “MOS E HAP”, OFERTA SIPAS THIRRJES PUBLIKE 4-1/2017 PËR SHITJE TË PRONËS SË PATUNDSHME (me shënim të numrit rendor dhe titullit të pronës së patundshme për të cilat dedikohen ofertat) deri më 10.01.2018, deri në orën 14.
5. Ofertat e dhëna nga personat fizikë duhet të përmbajnë: Çmim të ofruar në MKD pa TVSH; Pagesë të depozitit prej 30.000,00 MKD për objektin për të cilin dorëzohet ofertë me dëshmi kopje nga ekzemplari nga pagesa e realizuar, emër dhe mbiemër të ofertuesit; numri i letërnjoftimit, adresa e banimit, e-adresa dhe telefoni për kontakt.

6. Ofertat e dhëna nga personat juridikë duhet të përmbajnë: Çmimi i ofruar në MKD pa TVSH; pagesë të depozitit prej 30.000.00 MKD për objektin për të cilin dorëzohet ofertë me dëshmi – kopje të ekzemplarit të pagesës së realizuar, emri i personit juridik dhe adresa (sipas regjistrimit); numri tatimor; xhiro-llogaria në vlerë të denarit dhe banka – deponues; emri i nënshkruarit të autorizuar dhe telefoni për kontakt, faksi dhe e-adresa.
7. Depoziti të paguhet në EVN Maqedoni SHA - Shkup, xhiro-llogaria 210059337735190, Numri tatimor MK 4030005565759, Deponues NLB Tutunska Banka SHA Shkup.
Ofertat duhet të jenë të shkruara me kompjuter/makinë shtypi dhe të nënshkruara personalisht. Ofertat pa këto elemente nuk merren në shqyrtim.
8. Ofertat dorëzohen personalisht në arkivin e “EVN Maqedoni SHA. Shkup” – Shkup, rruga “11 Tetori” nr. 9, 1000 – Shkup ose nëpërmjet postës me afat të kufizuar. Ofertat duhet të arrijnë dhe të pranohen / të regjistruara në arkivin e “EVN Maqedoni SHA Shkup” – Shkup, rruga “11 Tetori” nr. 9, 1000 – Shkup më së voni deri më 10.01.2018, deri në ora 14:00. Ofertat të cilat do të arrijnë në arkivin e EVN Maqedoni pas afatit të shënuar nuk do të merren në shqyrtim.
9. Shitësi do të bëjë hapjen e ofertave të arritura gjatë së cilës Shitësi mban të drejtën të realizojë procedurë negociatash lidhur me ofertat pas dorëzimit të ofertave.
10. Shitësi ka të drejtë të aktivizojë depozitin, gjegjësisht të mos e kthejë depozitin e Ofertuesit më të volitshëm nëse Ofertuesi më i volitshëm (blerësi) nuk kryen pagesën e mjeteve në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga data e konfirmimit për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm ose blerësi ka tërhequr ose ndryshuar ofertën pas afatit përfundimtar për dorëzimin e ofertave.
11. Depoziti i ofertuesve tjerë do të kthehet nga ana e EVN Maqedoni në afat prej katërmëdhjetë (14) ditë nga dita e hapjes së ofertave, gjegjësisht nga dita e procedurës së realizuar për negociatën, nëse Shitësi realizon të drejtën që të realizojë procedurë për negociatën.
12. Afati për pagesë të mjeteve të përgjithshme financiare nga oferta është 7 (shtatë) ditë pune nga dita e konfirmimit të zgjedhjes së ofertuesit më të volitshëm (Blerësit)
13. Shitja do të realizohet në pajtim me rregullat ligjore pozitive, të zbatueshme në pajtim me natyrën e objektit të patundshmërisë, lëndë e shitjes.
14. Shpenzimet të cilat do të burojnë nga shitblerja e pronës së patundshme (TVSH dhe tatimi i shitblerjes së pronës së patundshme) bien në barrë të Blerësit, gjithashtu edhe shpenzimet për verifikim të noterit janë në barrë të Blerësit.
15. Nëse ofertuesi më i mirë i zgjedhur nuk e paguan avansin në afatin e dhënë, pas kalimit të këtij afati llogaritet se nuk është i përzgjedhur për ofertuesin më të volitshëm.
16. Shitësi nuk është i obliguar ta pranojë cilëndo ofertë, gjegjësisht mban të drejtën të mos zgjedhë ofertuesin më të volitshëm për pronën e patundshme që është lëndë e kësaj thirrjeje publike.
17. Informacionet shtesë për shpalljen mund të merren prej orës 10 deri në orën 14, çdo ditë pune prej 26.12.2017 deri më 10.01.2018 tek personi:
 - për informacione për objektet dhe mundësinë e kqyrjes së objekteve ilija.kjiroski@evn.mk, Ilija Kiroski tel. 02 205 00 lokali 43457 dhe 072 933 457.
 - për çështje komerciale radoslav.jauleski@evn.mk, Radoslav Jauleski tel. 02 3 205-000 lokali 43129 dhe 072 933 129.



TRIMI I MIRË ME MAJMONË SHUMË

Është ende shumë i vogël për të folur, por ka qenë i zoti që pa thënë asnjë fjalë të bëjë shumë shokë... majmunë. Miqësia e pazakontë e 2-vjeçarit Samarth Bangarit me 20 majmunë është bërë objekt diskutimi në fshatin e tij në jug të Indisë. Xhaxhai i djalit thotë se është e çuditshme sjellja kaq miqësore e majmunëve dhe ai ka frikë se ndonjë ditë ata do e sulmojnë vogëlushin kur prindërit e tij të jenë duke punuar arat. Majmunët vijnë çdo ditë në të njëjtën orë për të takuar 2-vjeçarin. "Kur e gjejnë në gjumë, majmunët e zgjojnë dhe rrinë me të për 1 ose 2 orë", tregon xhaxhai.



ANULIMI I SPECIALES DESTABILIZON KOSOVËN

“Rreziku nuk ka kaluar. Seancë e jashtëzakonshme mund të thirret edhe gjatë kohës sa Kuvendi është zyrtarisht në pushim. Sërish do të tentohet që ligji të shfuqizohet. Kjo është një lojë e rrezikshme për vendin, në të cilën janë të përfshirë ata që mund të jenë subjekt i procedimit nga Gjykata Speciale”, ka thënë Mushkolaj



kaluar. Seancë e jashtëzakonshme mund të thirret edhe gjatë kohës sa Kuvendi është zyrtarisht në pushim. Sërish do të tentohet që ligji të shfuqizohet. Kjo është një lojë e rrezikshme për vendin, në të cilën janë të përfshirë ata që mund të

jenë subjekt i procedimit nga Gjykata Speciale”, ka thënë Mushkolaj për “Kohën Ditore”. Sipas tij, gjithçka po bëhet me qëllim të krijimit të një situatë të re për negociim të rasteve që mund të procedohen, por edhe për të dërguar

sinjal që, nëse ndodh ndryshe, situata mund të destabilizohet. Ndërkohë, përfaqësuesi i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, Xhavit Jashari, e ka pasur një porosi për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në

shënimin e 19-vjetorit të betejës të Tabet e Llapashticës në Podujevë, ai ka kërkuar nga ta që të mos e lejojnë funksionalizimin e Gjykatës Speciale, e cila do të merret me krimet e supozuara të UÇK-së. Të kundërtën, Jashari e ka quajtur keqpërdorim të votës së tyre nga deputetët e Kuvendit. “Në situatën çfarë sot jemi ka vend për kritika, ka shumë vend për të shprehur dilema se a po realizohet amaneti i dëshmorit, se a po respektohet lufta e drejtë dhe e pastër e UÇK-së? Dhe unë me përgjegjësinë morale dhe njerëzore ju them para jush se jo. Sepse pas përfundimit të luftës janë krijuar institucionet e Republikës së Kosovës dhe këto duhet të jenë më të gatshme dhe më këmbëngulëse që të mos lejohet të degradohet lufta ose të krijohen siç nuk kanë hapur madje edhe rrugë të zgjedhurit tanë që të krijohet Gjykata Speciale për t'u dënuar kinse lufta e UÇK-së dhe se pjesëtarët e saj kanë bërë krime”, është shprehur Xhavit Jashari në këtë tubim. Edhe drejtoresha e organizatës “Iniciativa e re qytetare” me seli në Mitrovicën Veriore, Jovana Radosavljeviq ka vlerësuar se nisja e 43 deputetëve të parlamentit të Kosovës për shfuqizimin e ligjit Gjykatën Speciale paraqet një krizë serioze të shkaktuar nga elita politike e Kosovës. Sipas saj, një nisje e tillë mund të jetë katastrofale për të gjithë, dhe sidomos për komunitetin serb.

VEPRIMET E THAÇIT, HARADINAJT DHE VESELIT, SHKATËRRUESE PËR VENDIN

Deputeti i Parlamentit të Kosovës, Korab Sejdiu, i cili njëherësh është jurist me profesion, thotë se tentativa e presidentit Hashim Thaçi, e kryeministrit Ramush Haradinaj dhe e kryeparlamentarit Kadri Veseli për ta shfuqizuar Ligjin për Gjykatën Speciale ishte për ta shpëtuar veten nga kjo e fundit dhe për t'i rritur, siç thotë ai, pazaret në prag të fillimit të arrestimeve. Këto komente Sejdiu i ka bërë gjatë një interviste për gazetën “Zëri”, duke shtuar se të premtën u pa

qartë një blof i tillë i trojkës (Thaçi, Haradinaj dhe Veseli), që, sipas tij, po e shkatërron Kosovën. Juristi Sejdiu thotë se në lidhje me iniciativën e fundit nuk bëhet fjalë për një ligj të rëndomtë, por, siç thotë ai, për një përpjekje pak më të madhe në kontekst të votave që nevojiten për ta bërë një ndryshim të tillë, i cili ka edhe implikime kushtetuese dhe një investim shumë të madh nga partnerët ndërkombëtarë, në veçanti nga SHBA-ja dhe BE-ja.

GJURIQ PËR MARRËDHËNIET ME PRISHTINËN

58 për qind e Kosovës është e Serbisë



Në vazhdim të dialogut me Prishtinën, Beogradi do të insistojë të verifikojë çdo gjë që i takon pasurisë serbe në Kosovë. Kadastra thotë se 58 për qind e tokës së Kosovës është në pronësi serbe, thotë Marko Gjuriq. Sipas tij, zgjidhja e marrëdhënieve pronësore në Kosovës do të jetë njëri nga kushte kryesore të palës serbe në mënyrë që të arrihet normalizimi i gjithanshëm i marrëdhënieve me Prish-

tinën. Gjithnjë sipas tij, në vazhdim të dialogut të Brukselit, Beogradi do të kërkojë rishikimin e privatizimit në Kosovë e me këtë iniciativë zyrtarisht do t'i drejtohet UNMIK-ut e EULEX-it. Gjuriq, duke folur për gazetën “Novosti” të Beogradit, thotë se privatizimi në Kosovë është bërë pa i respektuar dispozitat e UNMIK-ut dhe pa pajtimin e bashkësisë serbe dhe të Serbisë. Kështu, sipas tij Serbia

është dëmtuar me shumta të paqumeshme parash. Në kuadër të bisedimeve për pronën që i pret, Beogradi, në veçanti do të kërkojë në, siç thotë Gjuriq, në restituimin natyror të pasurisë kishtare, që do të thotë kthim të tokës së marrë manastireve e jo dëmshpërblim për të. Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë ka thënë se “studimi i gjithanshëm për privatizimin në Kosovë thotë se më shumë se 900 ndërmarrje janë bërë me titullarë jo legalë dhe pa pëlqim të pronarëve të vërtetë dhe se e gjithë kjo, tha ai, është prezantuar në sesionin e fundit të dialogut të Brukselit “Për kërkesat e veta Beogradi ka mbulesë me letra, sepse evidenca kadastrale thotë se 58 për qind e tokës në Kosovë është pronë serbe. Në pronën shtetërore e shoqërore është 29 për qind e saj, 14 për qind gjendet te subjektet ekonomike, ndërsa në pronën private e kishtare është 15 për qind e territorit të Kosovës”, ka thënë Gjuriq.

Refugjatët kubanë mbesin në Serbi

Duke udhëtuar me aeroplanë në drejtim të Rusisë, ku mund të hyjnë pa pasur viza në pasaportë, shtetasit e Kubës po vazhdojnë rrugën e tyre drejt Malit të Zi, Maqedonisë ose Serbisë, shkruan “Koha Ditore”. Në këto ish-republika jugosllave, ata ende mund të marrin vizë turistike prej tridhjetë ditësh për shkak të lidhjeve të vjetra diplomatike të Kubës me Jugosllavinë e dikurshme, prej të cilave dolën shtetet e pavarura sllave në Ballkanin Perëndimor. Një vit pas qarkullimit të imazheve të refugjatëve që mezi po mbijetonin

në Beograd që shkaktuan zemërim anembanë botës, disa refugjatë po vazhdojnë të përballen me gjendje të mjerueshme në këtë shtet në Serbi. Përderisa të dhënat e Komisarariatit të Lartë për Refugjatët të Kombeve të Bashkuara tregojnë se ka rënie të numrit të refugjatëve të regjistruar në Serbi - prej rreth tetë mijë sa ishin në mars 2017 në më shumë se katër mijë në dhjetor - Mjekët pa Kufij raportojnë se janë qindra sosh që ende përballen me gjendje të vështirë gjatë qëndrimit të tyre nëpër kampet serbe.



SHBA shkurton buxhetin në OKB

Shtetet e Bashkuara kanë përgëzuar vendimin për shkurtrimin e buxhetit në Kombet e Bashkuara për 285 milionë dollarë gjatë vitit fiskal 2018-19, duke e cilësuar këtë si "hap të madh në drejtimin e duhur". Asambleja e Përgjithshme ka njoftuar se ka miratuar buxhetin në vlerë 5.396 miliardë dollarëve për dy vitet e ardhshme, apo 285 milionë dollarë më pak se periudha para-prake. Sidoqoftë Shtetet e Bashkuara mbeten sërish vendi që kontribuon më së shumti në OKB, me 22 për qind të buxhetit të përgjithshëm të kësaj organizate. Ambasadorja amerikane në OKB, Nikki Haley, ka thënë se "joefikasiteti dhe tejkalimi i shpenzimeve" në këtë organizatë ka qenë i ditur tashmë. "Ne nuk do të lejojmë që nga bujaria e popullit amerikan të përfitojë dikush apo ajo të mbetet e pakontrolluar", ka thënë ajo. Javën e kaluar presidenti amerikan, Donald Trump ka kërcënuar se do të ndalojë ndihmën financiare për vendet që votojnë rezolutën e OKB-së, me anë të së cilës kundërshtohet vendimi i SHBA-së për njohjen e Jerusalemit, kryeqytet të Izraelit. Rezoluta është miratuar me 128 vota për dhe nëntë kundër.

Dorëzo armën, merr para

Qindra persona i janë përgjigjur një programi komunal për shkëmbim të armëve në qytetin amerikan, St. Louis, Missouri. Zyrtarët kanë thënë se shumë persona kanë kërkuar shkëmbimin e armëve të tyre me të holla, aq sa nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare për blerjen e gjithë armëve të ofruara. Më shumë se 200 vrasës janë regjistruar gjatë këtij viti në St. Louis, shifra më e madhe në 20 vitet e fundit. Zyrtarët kanë hedhur fajin tek përhapja e armëve në rrugë për rritje të dhunës. Sipas programit, për një armë është paguar 100-200 dollarë, pa kërkuar ndonjë sqarim nga pronari. Disa kompani dhe individë kanë mbledhur donacione në shumë prej 125.000 dollarësh për të paguar këto armë. Policia ka thënë se të gjitha armët do të shkatërrohen. Presidenti i Fondacionit Policor në këtë vend, Doug Albrecht, ka thënë se një plan i tillë do të zbatohet edhe më 2018, mirëpo nevojitet më shumë financim.



PSE ËSHTË KAAQ I PREFERUAR MACRONI

Në sondazhe, mbështetja për Presidentin francez së fundi është shtuar shumë. Me një kombinim të rafinuar politik ai iu drejtohet qarqeve të ndryshme ideologjike - atyre që kërkojnë fillim të ri, por edhe konservatorëve

Shëtitja nisi në katin e parë, drejtpërdrejt në zyrën e Presidentit. Ai e bën të qartë që në fillim: ai punon shumë dhe fle pak. Në këtë kuptim, ky është nënteksti i kësaj të dhëne - pushteti i tij është i legjitimuar - jo vetëm përmes rezultati të zgjedhjeve, të cilat e katapultuan Macronin këtë vit në postin më të lartë të shtetit; por edhe me sjelljen e tij personale, përkushtimin pa kushte ndaj detyrës, krejtësisht në të mirë të popullit. Për "popullin tim" foli Emmanuel Macron në intervistën 40 minutëshe në stacionin televiziv France 2. Kjo shprehje nuk u prit mirë kudo, ajo të kujtonte shumë qëndrimin e një "roi soleil", të një "mbreti diell", i cili i erdhi në mend gazetës "Le Monde". Si një lloj "monarku republikan" e përshkroi ajo Presidentin. Me këtë gazeta preku thelbin e inskenimit të përshtypjes, të cilën synon të aktivizojë te spektatorët shtabi i presidentit: pikërisht kombinimin në njërin anë të motiveve madhështore dhe nga ana tjetër të motiveve të përditshme. Këtu shkallarja e nderit me një qilim të gjatë të kuq në Pallatin Elize, atje presidenti dinamik i ri, i thelluar në bisedë me reporterin.

Ai kërkon të hetojë cili është "fati i Francës", i tha në besim Macroni reporterit në shëtitjen në rezidencën presidenciale. Një fjali e madhe - e pritur me shpoti në internet, por në përgjithësi me sa duket sipas shijes së pjesëve të gjera të publikut.

"Francezët e vlerësojnë një lloj vertikalizmi të pushtetit", shkroi Le Monde, duke iu referuar jo vetëm intervistës televizive.

PRESIDENTI I RI

Në fakt, Macroni po përjeton një rritje në sondazhe, duke u dalluar këtu dukshëm nga dy paraardhësit e tij Sarkozy dhe Hollande, të cilët të dy, pas një gjysme viti në post, kishin rënie të dukshme në preferencë në popull. Krejt e ndryshme është situata me Macronin: në bazë të sondazheve të Institutit Demoskopik Ifop, Macroni, pas një faze të perkohshme të ulët në gusht, kur vetëm 40 për qind e francezëve mendonin mirë për Presidentin, tani ka një mbështetje prej 52 për qind. Macroni është popullor për një sërë arsyesh. Më e dukshme: mosha e tij e re. Të enjten ai mbushi 40 vjeç. Me këtë ai nuk është i vetëm në Evropë. Sebastian Kurz në Austri, Jüri Ratas në Estoni, Leo Varadkas në Irlandë - të gjithë këta janë në të 30-t. "Popujt kanë vendosur që të largojnë brezin, i cili ka dështuar në periudhat e krizave (papunësia, varfëria, imigrimi)", e komenton Christoph Barbier, kryeredaktori i revistës politike "L'Express", tendencën ende të përmasave të kufizuara. "Disa popuj kanë vendosur për populizmin, të tjerë për rininë, dhe të tjerë populizmin në formën e rinisë". Pritet të shihet nëse ky brez do të ketë sukses, por kërkesa thelbësore që qën-

dron pas kësaj është e qartë: "Mos u përpuni të riparoni një botë të vjetër - shpikni një botë të re".

MBËSHTETJE EDHE TE EVJETRA

Por Macroni vë në themel të Francës së re pjesë të së vjetrës. Tregu i punës, arsimit, imigrimi: në këto fusha ai ka vënë thekse të reja ose po e bën këtë. Reforma e tij e tregut të punës, në thelb një zhërvjelltesim dhe zbutje e mbrojtjes në punë për punëmarrësit, vërtet që ka nxjerrë në rrugë shumë francezë, por edhe gjen mbështetje në pjesë të gjera të popullit. Le Monde përshkruan përshtypjen e jo pak qytetarëve se Macroni po e nxjerr vendin nga bllokada dhe po e bën këtë me një ekip kompetent. Këtu ai dallohet mjaft nga shumë paraardhës të tij. Edhe në arsim ai mbështet një kurs më të rreptë, të orientuar më pak te multikulturalizmi. Këtë ai e ndjek edhe në punën për një ligj të ri imigrimi, i cili do të shtrojë kërkesa të larta ndaj të gjithë atyre që duan të vijin në Francë. Duket se bota e re e Macronit është më pak një shpikje krejtësisht e re, se sa një largim nga qëndrimi laissez-faire, ndaj të cilit ndihet e detyruar qeveria e larguar e Hollandes. Jo më kot ai po bën për vete gjithnjë e më shumë zgjedhës të Frontit të Djathtë Nacional. 35 për qind e tyre kanë sipas sondazheve përshtypje të mirë për të. (DW)

PËR 48 ORË DO TË DIHET FATI I DJALOSHIT XHUNEJDI



Prokuroria izraelite ka apeluar vendimin për lirim të palestinezit 16-vjeçar Fevzi al-Xhunejdi, i cili u shndërrua në simbol të rezistencës për Kudsin me fotografinë e shkrepur teksa arrestohej me sy të mbyllur nga ana e një numri të madh të ushtarëve izraelitë, të marrë nga Gjykata ushtarake e Izraelit, Ofer, raporton Anadolu Agency (AA). Xhaxhai i

Fevziut, Reshad el-Xhunejdi, në një deklaratë për AA tha se, gjykata e Ofer-it ka marrë vendim që nipi i tij të lirohet me dorëzani prej 2 mijë e 860 dollarë, ndërsa prokuroria ka apeluar këtë vendim. Ai tregoi se avokati i Fevziut ka kërkuar nga gjykata që të japë vendimin përfundimtar brenda 48 orëve. Ndërsa avokati i Shoqatës së Burgosurve Palestinezë,

Erva Hulejhil, do të ankohet tek Lëvizja Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve, në lidhje me shkeljet që është ekspozuar Fevziut. Fotografia e palestinezit, Fevzi al-Xhunejdi, me sy të lidhur duke u arrestuar në El-Halil (Hebron) të Bregut Perëndimor të okupuar nga shumë ushtarë më 7 dhjetor, kishte tërhequr vëmendjen në rrjetet sociale.

HISTORIA E KGB-së

KUR DIPLOMATËT E HUAJ ZIHESHIN NË KURTH NËPËRMJET SEKSIT

Një tjetër viktimitë i KGB-se ka qenë dhe lideri rus Boris Jeltsin, i cili u gjet i dehur dhe i lagur në një nga bodrumet e një stacioni të policisë së Moskës nga ndihmësit e tij në 1990. Jeltsin tha se "KGB kërkoi të më vinte poshtë". Çuditërisht, Jeltsin do t'ia kalonte disa vite më vonë, presidencën e Federatës Ruse, njërit prej shefave të KGB-së, presidentit aktual rus Vladimir Putin, ndërsa për ministër të jashtëm ose kryeministër do të caktonte një tjetër shef të KGB-së, Jevgeni Primakov

Shërbimi sekret më i frikshëm i botës, KGB-ja sovjetike ka qenë e njohur në të kaluarën e saj me shumë emra, por fillimet i ka në Revolucionin Bolshevik të 1917-ës. Më 20 dhjetor 1917 themelohet ÇEKA, forca e parë sovjetike e policisë sekrete; Çeka (akronim rusisht për komitetin e emergjencës) u krijua me një dekret të lëshuar nga Vladimir Lenini, dhe u drejtua më pas nga Feliks Xherzhinsky, aristokrat renegat, i kthyer komunist. Në fund të vitit 1918, qindra komitete ÇEKA ishin krijuar në qytete të ndryshme. Në vite, shumë mijëra disidentë, dezertorë, apo njerëz të tjerë u arrestuan, torturuan, ekzekutuan nga çekistët. Pas vitit 1922, ÇEKA pësoi një seri riorganizime e ndryshime emrash. Trupat çekiste ishin përgjigjes për kampet e punës; menaxhimin e sistemit Gulag; miratonin listat me emrat e kundërshtarëve politikë; kryenin arrestime, hetime, tortura, ekzekutime dhe shtypje të çdo pakënaqësie a rebelimi të mundshëm. Çeka u bë gjithashtu model i organizimit të armës së sigurimit të shtetit në vendet e bllokut komunist.

Me vdekjen e Xherzhinskut në 1926, organizata u përhap më shpejtësi për të mbajtur dhe rforcuar pushtetin e Josif Stalinit, diktatorit sovjetik. Deri dhe në kolektivizimin e BRSS ndërhyri kjo organizatë, me pasoja të tmerrshëm në miliona ruse që e kundërshtonin. Ata u ekzekutuan nga skuadrat vrasëse të OGPU-së. Në 1934, emri i organizatës ndryshoi përsëri, kësaj radhe në NKVD (Komisariati i Popullit për Punët e Brendshme, 1934-1946), i drejtuar nga Jenrik Jagoda, njeri i zgjedhur nga vetë Stalini. Nën udhëheqjen e Jagodës, NKVD mori një kontroll total të industrisë, profesioneve të ndryshme, punëtorëve, kooperati-

vistëve, të gjitha mjeteve të informacionit publik dhe forcave të policisë. Më një fjalë kontrollonte jetën e çdo gjëje të gjallë në Rusinë Sovjetike. Jagoda ishte bërë figura më e frikshme në Bashkimin Sovjetik pas Stalinit, i fuqishëm dhe i frikshëm. Ai ekzekutoi të gjithë ata që Stalini donte t'i eliminonte, derisa një ditë Stalini paranojak që shihte kudo "armi që popullit" dhe "agjentë të imperialistëve" e akuzoi për veprimtari subversive dhe e ekzekutoi. Yagoda u vra faktikisht në zyrën e tij. U mbyt nga duart e zëvendësit të tij, Nikollai Jezhovit, i cili ishte po aq barbar sa Jagoda. Jezhovi ka qenë i njohur historikisht dhe më nofkën "Xhuxhi i Përgjakshëm".

Por si gjithë limonët që pasi shtrydhen, hidhen në koshin e plehrave dhe Jezhovi u ekzekutua më urdhër të Stalinit në 1938. Atëherë në krye të NKVD erdhi një njeri shumë i afërt me Stalinin, Lavrenti Beria, i cili qëndroi në krye të

NKVD deri pas vdekjes së Stalinit. Gjatë kohës së Berias, NKVD u quajt MVD (Ministria e Punëve të Brendshme, 1946-1954) dhe një vit pas vdekjes së Stalinit u quajt në KGB. Zyrat qendrore të KGB janë të njohura dhe si Qendra dhe përveç të tjerave ka nën drejtim dhe GRU (Drejtorinë Qendrore të Zbulimit të Ushtrisë së Kuqe), që merrej më zbulimin dhe kundërzbulimin ushtarak. Të gjitha këto ishin nën mbikëqyrjen e KGB-së. KGB-ja ishte e plotfuqishme dhe operationet e saj ishin pa kufizime ligjore dhe rregulla dhe drejtohen dhe kundër popullit rus dhe kundër "armiqve të jashtëm".

Dega më e frikshme dhe më e fuqishme e KGB-së ishte SMERSH. SMERSH-i është një seksion i armatosur i veçantë i KGB-se që merrej më dënimet dhe ekzekutimet e çdo rusi të cilësuar si "tradhtar", të çdo informatori apo agjenti që dezertonte në Perëndim, të çdo komunisti që nuk ndiqte vijën e Par-

tisë si dhe një numër të madh viktimitash jashtë Rusisë (sovjetikë ose qytetare të shteteve të tjera). Loja e preferuar e KGB-së ishte futja në kurthin e saj të diplomatëve të huaj dhe në shumicën e rasteve bëhej nëpërmjet seksit. Në këtë mënyrë KGB-ja komprometoi ambasadorin britanik në Moskë, Sër Xhofri Harison në 1968. Ambasadori u dashurua pas një gruaje të bukur ruse që punonte si shërbëto-re në ambasadën britanike e quajtur Galja. Ajo ishte sigurisht e futur më mision aty nga KGB-ja. Pasi çifti mbaroi punë në një apartament të Leningradit, Harrisonit iu treguan foto të tij me Galian duke bërë seks. Harrisonin iu komunikua se në qoftë se nuk i jepte KGB-së informacionet që ajo kërkonte, fotot dhe lidhja e tij me Galian do të bëheshin publike. Në vend që të bashkëpunonte, Harrisoni u kthye në Londër ku pohoi lidhjen në Galian tek oficeret e MI5 (Kundërzbulimi britanik). Ai u nxor

në pension menjëherë. Megjithëse ky lloj kurthi kësaj radhe dështoi, shumë kurthe përpara Harrisonit ishin të suksesshëm.

Një sukses i tillë ishte komprometimi i ambasadorit francez në Moskë, Moris Dezhanit. Çifti Dezhan arriti në Moskë nga Parisi në 1955 i gatshëm për të bërë miq sovjetikë në rangje të larta. Ata u pritën nga shumë persona që thoshin se ishin udhëheqës sovjetikë, por në të vërtetë ishin ose oficerë të KGB-së ose spiunë të saj. Një prej tyre ishte dhe gjeneral lejtant Oleg Mihailoviç Gribanov, i cili u paraqiti tek çifti më emrin Gorbunov. Dezhani i tha në konfidencë Gribanov/Gorbunovit se i pëlqenin femrat e pashme dhe pas kësaj në hapat e ambasadorit, "rastësisht" rreshtoheshin femra të pashme të gatshme të flirtonin me të. Këto gra, quheshin "Thithëse" nga bosat e KGB-së dhe ambasadorit i ofroheshin nga agjenti i KGB-së, Juri Vasilevic Krotkov. Krotkovi e njohu Dezhanin me disa aktore filmi ruse, njëra prej të cilave quhej "Lora". Kur Dezhani ishte duke bërë dashuri me të, bashkëshorti i saj imagjinari ia behu në dhomë duke i kapur flagrancë dhe e kërcënoi Dezhanin se do ta çonte në gjyq publik, një skenar i vjetër i KGB-së. Më vonë atë natë, Dezhani nervoz përsëri në konfidencë i tha shqetësimin e tij Gribanov/Gorbunovit i cili ngrohtësisht nga ana e tij e garantoi se do të përdortë influencën e tij që të qetësohej "bashkëshortin e nxehtë". Ai e informoi Dezhanin pas pak ditësh se çështja e tij ishte vënë në vijë dhe se ambasadori nuk duhet të shqetësohej më. Mirënjohës, Dezhani filloi atëherë më hir ose me pahir të jepte informacion tek Gribanovi. Loja e KGB-së për këtë çështje, nuk ndaloi me kaq. Ai u përpoq të fuste në kurth dhe gruan e ambasadorit, por pa



sukses. Meqë dështoi tek zonja Dezhan, ai komprometoi një diplomat tjetër francez me një nga prostitutat e KGB-së.

Koloneli Lui Gibo, atasheu ajror francez sidoqoftë nuk bashkëpunoi me KGB. Në vend që të jepte informacion dhe të fshihte lidhjen, ai vrau veten. Agjenti Krotkovi më vonë, në 1963 vizitoi Londrën si shoqëruar i disa shkrimtarëve sovjetike. Me marifet ai dezertoi dhe u dorëzua tek anglezët ku tha se dezertimi i tij ndodhi nga brejtja e ndërgjegjes për çështjen Gibo. Në të njëjtin vit, Gribanovi u informua se një spiun i KGB-së ishte kapur në Nju Jork, SHBA. Të dëshpëruar për të pasur një spiun amerikan, që ta shkëmbejnë me atë sovjetik, bosat e KGB-se e urdhëruan Gribanovin të gjente një agjent amerikan me porosi. Atë që oficerët mundën të gjenin ishte një mësues amerikan, Frederik Bargun, një profesor i universitetit të Jeill, i cili ndodhej si turist në Moskë. Agjentët e KGB-se i thanë Gribanovit se fatkeqësisht profesori nuk ishte spiun. "Bëjeni spiun" u bërtiti Gribanovi. Barguni u arrestua, por më vonë doli se ishte mik personal i presidentit Kenedi, i cili i dërgoi një notë protestë Hrushovit. Hrushovi me fytyrë të kuqe nga turpi dhe nga zemërimi, iu kanos Gribanovit dhe e urdhëroi ta lironte menjëherë profesorin. Diplomati, të cilët KGB-ja nuk mund ti komprometonte seksualisht për ti dhënë asaj informacion, ishin subjekt survejimi të vazhdueshëm, brenda dhe jashtë ambasadës, duke i ndjekur këmba-këmbës në çdo hap që bënin dhe duke i survejuar në ambasadë me aparatura të sofistikuar të cilat ishin fshehur më kujdes në ambasadat e huaja. Në 1975, Ambada amerikane në Moskë ishte në krye të listës për përgjime nga ana e sovjetikeve. Mikrofonat ishin të një sistemi të sofistikuar dhe drejtoreshin duke i komanduar nga jashtë ambasadës me rreze të larta të intensifikuar, nëpërmjet dritareve të ambasadës. Duke shënuar me këto rreze vazhdimisht, dyshohet që teknikët e KGB-së, pa dashje infektuan më helmim radiologjik ambasadorin amerikan Uolltër Stosel. Stosel u kthye në Uashington ku u shërua nga overdoza e radiacionit, kushte në të cilat jetonin shumica e diplomatëve në BRSS, ngaqë masat dhe kundërmasat e KGB-se për aparaturat e përgjimit sa vinin e bëheshin më të sofistikuar. Një nga arsytet për të damkosur amerikanët si spiunë ishte për të treguar se spiunazhi kundër Revolucionit Sovjetik vazhdonte dhe revolucioni ishte në rrezik të vazhdueshëm. Ishin apo jo spiunë, kjo nuk kishte rëndësi, ata damkoseshin vetëm për terror. Një rast i tillë ishte dhe çështja e Martha Pitersen, e cila ishte pjesë e trupit diplomatik amerikan. Agjentët e KGB-se raportuan se kishin gjetur mesazhe sekretë të drejtuara asaj në një kuti postare të vdekur (Kuti postare e vdekur



në gjuhen e spiunazhit quheshin vendet e fshehta ku agjentët shkëmbejnë mesazhet e tyre të shkruara. Këto mund të ishin banjo publike në një restorant të caktuar, një vrimë në një pemë në një park, etj. Në këtë mënyrë evitohej komprometimi dhe kapja nga kundërshtarët). Pitersen u dëbua nga Bashkimi Sovjetik.

Të njëjtin fat pati dhe Ricard Ozborn, sekretari i ambasadës amerikane për çështjet ekonomike. KGB-ja lajmëroi se Ozborni u arrestua në maj 1983, duke thënë se u kap në flagrancë duke transmetuar mesazhe nga një radio tek një satelitë komunikacionesh "Marisat". Kur ambada kërkoi prova të mesazheve ose kopje të tyre për të provuar fajësinë e Ozbornit, KGB tha se shënimet e Ozbornit ai i kishte shkatërruar duke i tretur në ujë. Ozborni, e shoqja dhe dy fëmijët u dëbuan nga Bashkimi Sovjetik. Shumë nga funksionarët e KGB-së që kishin urdhëruar në komprometimin e diplomatëve dhe arrestimet e tyre ishin fare pak të sofistikuar në krahasim me ata që zhvilluan teknologjinë e spiunazhit të KGB-së. Në të shumtën e rasteve ishin vrasës, brutalë dhe arrogantë që kishin bere vrasjet dhe ekzekutime për llogari të Stalinit, si në kohë të Revolucionit, ashtu dhe më pas. Duke mos pasur më vlerë për të, ata që u kishin shpëtuar shpatës se tij, ishin ngujuar në zyra në KGB. I tillë ishte për shembull dhe Boris Nikolaevic Ponomarev, i cili ka qenë funksionar i KGB-së që në ditët kur ajo quhej CHEKA. Ishte ky që organizoi tradhtinë dhe arrestimin e presidentit çekoslovak Aleksandër Dubcekut në Prage në 1968. Ponomarev ka qenë drejtues i departamentit ndërkombëtar të KGB-së, departament që më vonë kaloi në duart e Juri Andropovit. I ngjashëm me Ponomarevin ka qenë dhe Sergei Kruglov, një nga vrasësit më të besuar të Stalinit dhe dikur anëtar i SMERSH-it. Kruglovi ka qenë në Rojën e Kuqe gjatë Revolucionit. Ai u ngrit në gradën e kolonelit dhe ishte komandant i Gardës së Kremlinut. Nga 1920 deri në 1930 Kruglovi ka qenë i njohur si "këmbëza" e Stali-

nit, duke ekzekutuar çdo njeri që zgjidhte Stalini. Ai ishte një nga anëtarët e CHEKA-s që i mbijetoi 5 shefave të saj, madje thuhet sikur ai i ka vrrarë me dorën e tij Jagodën dhe Jezhovin me urdhra të Stalinit, si dhe thuhet se ka shkaktuar vdekjet misterioze të tre shefave të tjerë të KGB-së.

Dihet nga të gjithë se Kruglovi qëllon dhe vrau personalisht Marshallin Mihail Nikolajevic Tuhacevski, shefin e përgjithshëm të shtabit të Ushtrisë së Kuqe, pjesë e komplotit stalinian për spastrimet në ushtri në 1937. Për këtë shërbim, Kruglovi u be gjeneral "nderi" dhe zv/komisar i Punëve të Brendshme. Ai ka pasur dore në të gjitha operacionet kryesore të SMERSH-it si dhe në vrasjen e Trockit, njërit prej liderëve të Revolucionit që Stalini e urrente pa masë sa askush tjetër në botë. Kruglovi ishte kaq njeri i besuar i Stalinit, sa që gjatë luftës së dytë botërore, ai u urdhërua nga Stalini të merrej më çështjet e sigurimit në konferencat e Jaltës, Teheranit dhe Potsdamit. Për këtë veprim, Kruglovi u dekorua dhe nga fuqitë perëndimore, ai mori "Urdhrin e Legjionit të Meritës" nga qeveria e SHBA dhe një titull kalorësiak nga Perandoria Britanike. Pas vdekjes së Stalinit, Kruglovi u be ministër i Brendshëm e cila në atë kohe kombinonte me Ministrinë e Sigurimit Shtetëror. Bosi i KGB-së, Lavrenti Beria, një nga shokët e Kruglovit, e mbështeti hapur atë fillimisht, por duke mos pasur besim tek vrasësi i vjetër ai sugjeroi që Kruglovi kishite mbledhur shumë pushtet rreth vetes. Në prill 1954, Komiteti për Sigurimin e Shtetit u shkëput nga ministria e Kruglovit dhe u vu nën komandën e gjeneralit Ivan Serov, më vonë drejtor i KGB-së. Kështu Kruglovi u hoq nga rruga e Berias për pushtet. Ai u nxor në 1956 në pension dhe u venit nga skena politike ngadalë. Agjentët e KGB-së kanë qenë nga spiunët më të trajnuar në botë. Megjithatë midis tyre ka një numër të madh dezertorësh në Perëndim, ata kanë arritur të penetrojnë në mënyrë fantastike që në vitin 1925 në administratat dhe shërbimet sekrete të shumë shteteve si: SHBA

(në administratën e Rusveltit), shërbimet sekrete angleze gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, në administratën dhe tek diplomatët e Gjermanisë nazistë dhe më pas të Gjermanisë Perëndimore, partitë politike komuniste ose jo në SHBA, Evropën Perëndimore, etj, administratën dhe shërbimet sekrete franceze etj, kanë mundur të rekrutojnë si agjentë të tyre gazetarë, avokatë të dëgjuar në perëndim, personalitete botërore, etj. Deri dhe në lojërat e ndërkombëtare të shahut të zhvilluara midis lojtarëve sovjetike dhe atyre rusë të arratisur në perëndim ka ndërhyrë KGB-ja me hipnotistët e saj.

Nëpërmjet agjentëve dhe informatorëve të tyre, KGB-ja vodhi nga amerikanët komplet planet dhe sekretet e prodhimit të bombës atomike që në 1943-44. Në vitet e Luftës së Ftohtë, agjentët e KGB-së janë përgjegjës për vjedhjen dhe marrjen e teknologjisë perëndimore në aq shkallë të lartë, sa që që të arrinte këtë teknologji shteti sovjetik duhet të shpenzonte më miliona orë pune e njerëz dhe miliarda rubla në fushën e kërkim-eksperimentimit. Pas Ushtrisë Sovjetike, KGB-ja ka pasur gjithmonë buxhetin më të madh që llogaritet në miliarda dollarë çdo vit për të mbajtur stafin e saj burokratik, më dhjetëra mijëra agjentë operativë dhe teknikë të panumërt për t'i mbështetur me teknologji dhe aparatura. Një nga shefat e CIA-s, Xhon Mkwkhon i raportonte Kongresit amerikan në 1982 se KGB-ja shpenzonte çdo vit 3 deri në 4 miliardë dollarë për të krijuar dizinformacion, propagandë dhe falsifikime (monedhash dhe dokumentesh). Një nga këto falsifikime ishin dhe letrat false midis presidentit amerikan Ronald Regan dhe mbretin Huan Karlos të Spanjës, në të cilat Regani ishte kundër pranimit të Spanjës në NATO, fabrikim i KGB-së. Tjetër fabrikim dhe propagandë e KGB-së ka qenë përhapja e disinformacionit sikur CIA ishte ajo që kishte vrrarë presidentin Kenedi dhe më pas në vitet '70-80, sikur CIA kishite fabrikuar dhe përhapur virusin e SIDA-s. Një nga gazetaret që përhapnin dhe shkruanin të tilla lajmë ka qenë dhe e përditshmja italiane "Paese Sera", e cila ka marrë me miliona dollarë nga KGB-ja gjatë viteve 1975-1986 për të paraqitur dezinformatat dhe propagandën e zezë të saj, transmeton tiranaobserver. Një tjetër viktimitë i KGB-se ka qenë dhe lideri rus Boris Jeltsin, i cili u gjet i dehur dhe i lagur në një nga bodrumet e një stacioni të policisë së Moskës nga ndihmësit e tij në 1990. Jeltsin tha se "KGB kërkoi të më vinte poshtë". Çuditërisht, Jeltsin do t'ia kalonte disa vite më vonë, presidencën e Federatës Ruse, njërit prej shefave të KGB-së, presidentit aktual rus Vladimir Putin, ndërsa për ministër të jashtëm ose kryeministër do të caktonte një tjetër shef të KGB-së, Jevgeni Primakov.



Trupat çekiste ishin përgjigjes për kampet e punës; menaxhimin e sistemit Gulag; miratonin listat me emrat e kundërshtarëve politikë; kryenin arrestime, hetime, tortura, ekzekutime dhe shtypje të çdo pakënaqësie a rebelimi të mundshëm. Çeka u bë gjithashtu model i organizimit të armës së sigurimit të shtetit në vendet e bllokut komunist



Pas Ushtrisë Sovjetike, KGB-ja ka pasur gjithmonë buxhetin më të madh që llogaritet në miliarda dollarë çdo vit për të mbajtur stafin e saj burokratik, më dhjetëra mijëra agjentë operativë dhe teknikë të panumërt për t'i mbështetur me teknologji dhe aparatura

MUHEDIN MAKRI

SKALITËSI GJIROKASTRIT I LULEVE TË GURTA

Prej 30 vjetësh
mjeshtri Muhedin
Makri gdhend në
gur punime
karakteristike

Dalta lëviz ngadalë në sipërfaqen e gurit, ndërkohë që goditjet ritmike të çekanit shpërndajnë dhjetëra copëza guri. Dalta duket se iu bindet në mënyrë besnike duarve që e shtrëngojnë fort duke ravijëzuar kështu mbi sipërfaqen e gurit formën e dëshiruar. Gurgdhendësi gjirokastri Muhedin Makri sapo ka filluar ti japë formë relievit të tij të radhës mbi një pllakë guri. "Nuk është edhe aq e lehtë ti japësh formën e dëshiruar gurit në disa raste ai është "kokëfortë" dhe nuk i bindet formës që kërkon ti japë dalta", thotë gurgdhendësi ndërsa e përshkuan gurin si diçka të gjallë.

Tashmë në një moshë afro të 70-ve Muhedini ka arritur të mësojë të gjitha të fshehtat e mënyrës së gdhendjes dhe punimit të gurit. "Ky zanat në fillim duket i vështirë pasi të duhet ti japësh formë gurit por me kalimin e kohës mua me ka pëlqyer dhe më ka bërë për vetë", thotë mjeshtri Makri, ndërsa shtrëngon fort në duart daltën dhe çekanin. Prej gati 30 vitesh ai punon dhe skalit në mënyrë artistike gurin duke krijuar nëpërmjet tij me dhjetëra punime. Në oborrin e shtëpisë së Muhedinit, në lagjen Dunavat, apo në shitoren e tij në Pazarin e gurtë do të gesh gjithçka prej guri, sylynjarë uji, drerë të gdhendur në gur, portrete njerëzore, ornamente dhe lule etj. Duket sikur ndjesia e së bukurës në shpirtin e tij është përjetësuar njëherë e përgjithmonë në këto punime të gurta. "Guri më ka nderuar kudo", thotë ai, ndërsa sjellë në mendje vitet e punës si gurgdhendës dhe skalitës i relieveve mbi sipërfaqen e pllakave të gurta. Madje për një periudhë përgjatë viteve 90-të ai ka punuar si emigrant edhe në Greqi, në Athinë.

Ai i ofronte athinjotëve të interesuar pas këtij zanati me dhjetëra forma dhe skalitje artistike në gur, të cilat zbkuronin oborret dhe dhomat e shtëpive. Tashmë ai realizon punime të ndryshme artistike të porositura nga njerëz të apasionuar pas gdhendjes së gurit. "Janë me dhjetëra porosi që më mbërrijnë nga njerëz të ndryshëm të cilët



kërkojnë të përjetësojnë një herë e përgjithmonë në gur portrete njerëzore, kafshë të ndryshme, lule etj.", thotë Muhedini, ndërkohë që mbi sipërfaqen e gurit që ai skalit ka filluar të formësohet një petale luleje. Por ndër punimet e ndryshme që ai ka realizuar më shumë i ka lënë mbresë gdhendja e një shqiponje". Mesa më kujtohet porositësi i saj kërkonte të vinte një shqiponje prej guri në qemerin e gdhendur të portës së shtëpisë", thotë Muhedini. Pas kishte marrë porosinë gurgdhendësi punoi për gati dy javë për të realizuar relievin e shqiponjës së gurtë. "Ishte diçka e veçantë për mua të gdhendja një shqiponjë guri pasi nuk kisha pa-



tur asnjëherë një porosi të tillë", thotë mjeshtri gurskalitës. Plot vullnet dhe pasion, duke punuar mbi gur rreth 12 orë në ditë ai arriti të përfundojë shqiponjën



ndërkohë që porositësi i saj ngeli mjaft i kënaqur. Janë mjaft punime artistike të gdhendura në gur nga Muhedini, të cilat zbkurojnë jo vetëm oborret dhe dhomat e brendshme të shtëpive gjirokastrore por porositësit janë edhe nga rrethet e tjera të Shqipërisë.

Të paharrueshme për mjeshtrin gjirokastri ngelen edhe gdhendja në gur e portretit të Kadare, Nënë Terezës apo portierit të Kombëtares së futbollit, Etrit Berisha. Goditjet e çekanit mbi daltë kanë shoqëruar gjithë bisedën me gurgdhendësin. Mbi sipërfaqen e gurit ai tashmë ka përfunduar punimin e radhës, një lule trëndafil me petale të gurta. "Kjo lule nuk ka për tu vyshkur asnjëherë", thotë gurgdhendësi Muhedin Makri ndërsa përkëdhel me gishtat e pluhurosura petalet e trëndafilin të gurtë.



Mesazhet e romanit "Emri i trëndafilin"

Ai nuk është thjesht një libër. "Emri i trëndafilin" është një kryevepër që duhet lexuar nga të gjithë dhe jo vetëm kaq, çdo vepër e Umberto Eco duhet lexuar për shumë arsye. Që nga fjalori i tij i pasur (fatmirësisht i përkthyer në mënyrë të përkryer në shqip), thënie të fantastike, subjektet interesante, e deri tek ironia e tij e bukur dhe therëse. Më poshtë do t'ju japim disa nga mesazhet që ai na sjell me veprën "Emri i trëndafilin":

"Kur armiq të vërtetë janë tepër të fortë, lind nevoja të zgjedhim armiq të tjerë më të dobët".

"Vlera e një libri duket në momentin që e lexojmë. Një libër përbëhet nga shenja që flasin për shenja të tjera dhe këto flasin më pas për gjëra. Pa një sy që t'i lexojë, një libër mban shenja që nuk prodhojnë mesazhe dhe me pak fjalë është i shurdhët".

"Librat nuk janë bërë për t'u besuar, por për të na ftuar në dyshime. Përpara një libri ne nuk duhet të besojmë çfarë na transmetohet, por të pyesim veten se çfarë ka dashur autori të transmetojë me fjalët e tij".

"E vërteta e vetme është të mësojmë se si të çlirohemi nga pasioni jo i shëndetshëm për të vërtetën".

"Kush nuk lexon, në moshën 70 vjeçare ka jetuar vetëm një jetë: të vetën! Kush lexon, ka jetuar 5000 vjet: Që kur Kaini vrau Abelin, kur Renzo u martua me Lucian, kur Leopardi adhuronte pafundësinë... sepse në thellësi leximi të dhuron pavdekësinë". / Bota.al

UMBERTO
ECO
Emri
trëndafilin



RRITET NUMRI I FUTBOLLISTËVE NGA MAQEDONIA TE SKUADRA VLONJATE



Për gazetën KOHA këtë lajm e ka konfirmuar edhe vet Gafuri, i cili tha se është në bisedime me Flamurtarin dhe trajnerin Duro dhe gjithçka do të dihet në ditët në vijim

GAFURI SHUMË PRANË KALIMIT TE FLAMURTARI

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 25 dhjetor – Skuadra e Flamurtarit ku trajner është ish-trajneri i Shkëndijës, Shpëtim Duro ka ndërtuar një skuadër të shkëlqyer këtë sezon, duke e mbyllur në vendin e dytë pjesën e parë të kampionatit, ndërsa tani kërkon përfortime për Flamurtarin. Pas afrimit të sulmuesit Nedeljkoviç dhe mesfushorit ofensivë Muarem Muarem, klubi vlonjat kërkon përfortime të

tjera në mesfushë e sulm dhe pas dështimit të transferimit të Dejvi Bregut, Duro kthen sytë përsëri nga Liga e parë futbollistike e Maqedonisë, aty ku ka marrë lojtarë mjaft cilësorë deri tani, që janë bërë pika kyçe te skuadra e tij. Emri i ri që del në skenë është ai i mesfushorit ofensivë Argjent Gafuri, mëson "Sport Ekspres", transmeton gazeta KOHA. Bëhet fjalë për anësin ofensivë 28-vjeçar, i cili luan në të dy krahët e mesfushës dhe sulmit.

Derisa për gazetën KOHA këtë lajm e ka konfirmuar edhe vet Gafuri. "Po është e vërtetë. Jemi në bisedime me Flamurtarin dhe trajnerin Duro. Gjasat janë të mëdha që të kaloj te skuadra nga Vlora. Gjithçka do të dihet në ditët në vijim", deklaroi Gafuri. Ndryshe, prej thujse një dekadë pjesë e Renovës, Gafuri nuk ka lëvizur asnjëherë nga kampionati maqedonas dhe prej vitit 2011 është një ndër lojtarët më të rëndësishëm të Renovës, duke

qenë ndër lojtarët më të aktivizuar dhe me një mesatare mjaft të mirë shënimi, por edhe asistimesh. Ndryshe, sezonin e shkuar Gafuri shënoi 8 gola në 34 ndeshje kampionati, ndërsa këtë sezon ka qenë titullar në të 18-ta e kampionatit, duke shënuar 4 gola, ndaj disa prej skuadrave më të mira të kampionatit. Kujtojmë, pos Muarem, pjesë e skuadrës nga Vlora janë edhe Artim Pollozhani dhe Muhamed Huseini.



Ramadani kandidat për trajner i Kukësit

Shkup, 25 dhjetor - Pas largimit të serbit Milinkoviç, banka e kampionëve të Kukësit ka ngelur vakant. Të shumtë janë emrat që kanë qarkulluar, por presidenti Gjici mesa duket nuk do të nxitohet në zgjedhje. Buri me të sigurt pranë "Panorama Sport" bëjnë me dije, se drejtuesit e klubit verilindor kanë pasur ditën e djeshme një takim me ish-trajnerin e Flamurtarit, Zekirija Ramadani. 39-vjeçari nga Shkupi shihet si një alternativë e mundshme nga ana e presidentit, pasi njeh mirë futbollin shqiptar. Kujtojmë, në sezonin 2010-2011, Ramadani ka qenë pjesë e Flamurtarit si futbollist, ndërsa në sezonin 2016, ai mori drejtimin e skuadrës vlonjate si trajner i parë. Aventura e tij nuk zgjati shumë me klubin kuqezi, për shkak të rezultateve të dobëta. Pas Flamurtarit, 39-vjeçari, drejtoi skuadrën kampione të Kosovës, Trepça 89', ndërsa së fundmi ishte pjesë e Feronikelit, derisa aktualisht është pa angazhim dhe në ditët në vijim do të mësohet se do të vjen në krye të Kukësit apo jo.



Ndoj pëlqehet nga një tjetër klub italian

Emanuele Ndoj nuk po gjen shumë hapësira te skuadra e Breshës dhe merkato e janarit mund të sjellë ndryshime për të. Mediat italiane shkruajnë se mesfushori i Kombëtares shqiptare po vëzhgohet nga Avelino dhe këta të fundit e shohin si një opsion të mirë për të përmirësuar cilësinë në repartin e mesfushës. Ai ka qenë pranë Avelinos edhe në merkato të tjera, por asnjëherë nuk është konkretizuar transferimi i tij.

Shkupi e mbyll sezonin vjeshtor me disfatë

Shkup, 25 dhjetor - Në ndeshjen e fundit të sezonit vjeshtor në Ligën e Parë të basketbollit në Maqedoni, skuadra e KB Shkupi nuk arriti të shënojë fitoren e tretë para publikut të vet në palestrën "Shaban Tërstena" në Çair. Kundërshtarë kishte ekipin e Kozhuvit nga Gjevgjelia, ekip kjo që gjithashtu

kishte vetëm dy fitore në këtë sezon. Ndeshja pothuajse gjatë gjithë kohës ishte e barabartë, me ndryshim të epërsisë kohë pas kohë. Interesante ashtu edhe siç pritej ishte çereku i katërt, kur vetëm dy minuta para fundit rezultati ishte i barabartë 61:61, por në këtë moment basketbollisti

mysafir, Miladin Pekoviç shënoi për tri pikë për shkëputje. Më pas deri në fund Shkupi humbi disa raste tjera, që në fund ndeshja të përfundon me rezultat të ngushtë 67:69. Shkupi mbetet në pozitën e poshtme të tabelës, ku së bashku me Pelisterin kanë vetëm nga dy fitore.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, nenit 37-e të Ligjit për ndërmarrje publike, Vendimit për nevojën për punëtor nr. 04-1250/1 të datës 20.12.2017, Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike për punësim dhe shpalljes së fillimit të punës për punësimin e fletëparaqitjes për punësim dhe avancim, mënyrës për realizim të selektimit për punësim dhe për avancim si dhe mënyrës së vlerësimit me pikë të ofruesve të shërbimeve publike nr. 02-393/6 të datës 01.06.2017 të sjellë nga Këshilli Drejtues i ndërmarrjes dhe nenit 34 të Statutit të NP Komunalec Kavadar ndërsa në pajtim me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës dhe Planit për punësim për vitin 2017 të NP Komunalec – Kavadar nr. 04-133/1 të datës 20.02.2017 si dhe të mendimit të dhënë pozitiv nga ana e Ministrisë së shoqërisë informatike dhe administratës me numër 12-1336/3 prej 04-132/2 të datës 07.08.2017, UD Drejtori i ndërmarrjes

Publikon SHPALLJE Për pranim të punëtorëve

I. NP Komunalec – Kavadar ka nevojë për pranim të punëtorëve për kohë të pacaktuar edhe atë për vendet e punës në vijim:

- 1. Drejtues të manipulantis – në Departamentin për kanalizim pjesa burimore dhe gypave Sektori për ujësjellësi dhe kanalizim 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 004, kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premtë ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës themelore është 15.380,00 denarë;
2. Punëtor në gjelbërim – në Departamentin e hortikulturës Sektori i higjienës komunale 2 (dy) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 015 kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premtë ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës është 13.870,00 denarë;
3. Punëtor murator në departamentin e varrezave (menaxhim me varrezat) Sektori shërbimet e përbashkëta 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V01 012, kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose paku një vit përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premtë ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës është 15.380,00 denarë;
4. Punëtor i përgjithshëm në Departamentin për rrjetin urban dhe rural të ujësjellësit Sektori ujësjellës dhe kanalizim 2 (dy) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 031 kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premtë ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës është 15.380,00 denarë;
5. Punëtor për mënjanimin e mbeturinave në Departamentin për mënjanimin e mbeturinave Sektori higjiena komunale 2 (dy) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 011 kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premtë ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës është 13.870,00 denarë;
6. Pastrues në Departamentin për higjienë publike (shërbyese) Sektori higjiena komunale 2 (dy) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 013 kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premtë ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës është 13.870,00 denarë;
7. Punëtor i përgjithshëm në Departamentin për kanalizim pjesa burimore dhe gypave Sektori për ujësjellësi dhe kanalizim 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 031, kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premtë ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës është 13.870,00 denarë;
8. Vozitës në Departamentin për mirëmbajtje të mekanizmit dhe makinave Sektori për higjienë komunale 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 04 03 A02 004 kandidatët të kenë

të mbaruar arsimin e mesëm, si dhe të posedojë leje të vozitjes të kategorisë C, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premtë ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës themelore është 15.500,00 denarë.
9. Vozitës i makinës së lehtë ose xhip për terren në Departamentin për mirëmbajtje të mekanizmit dhe makinave Sektori higjiena komunale 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 04 03 A02 001 kandidatët të kenë të mbaruar arsimin e mesëm, si dhe të posedojë leje të vozitjes të kategorisë përkatëse, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premtë ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës është 15.500,00 denarë.
10. Pirunier Departamentin për mirëmbajtje të mekanizmit dhe makinave Sektori higjiena komunale 2 (dy) realizues me shifër të vendit të punës KDR 04 03 A02 007 kandidatët të kenë të mbaruar arsimin e mesëm, si dhe të posedojë leje të vozitjes të kategorisë përkatëse, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premtë ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës është 15.500,00 denarë.

Kandidatët parashirojnë fletëparaqitje e cila duhet të përmbajjë përmbajtjen në vijim:
1. Të dhënat personale për kandidatit,
2. Të dhëna për përmbushje të kushteve të përgjithshme,
3. Të dhëna për përmbushje të kushteve të posaçme,
4. Deklaratë me vërtetim se të dhënat e përmbajtura në fletëparaqitje janë të sakta, ndërsa dëshmitë e dhëna janë të besueshme me origjinalin si dhe në pajtim të gjitha lajmërimet të parashitrohen në e-mail adresë ose përmes SMS porosive në telefon celular, gjegjësisht në adresën e shëruar në fletëparaqitje,

5. Data e paraqitjes dhe nënshkrim të kandidatit. Kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrje publike, ligjin për marrëdhënie pune ose marrëveshjen kolektive janë:
1. Të jetë shtetas i RM;
2. Të jetë i moshës madhore;
3. Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
4. Të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për ndalesë të kryerjes së profesionit ose detyrës. Kandidatët krahas fletëparaqitjes për punë të parashitrojnë dëshmi për arsimin e mbaruar si dhe dokument me të cilin i përmbushin kushtet e posaçme të lartpërmendura. Vërejtje: Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh. Shpallja është e hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit. Nëse në shpalljen publike janë paraqitur deri në 200 kandidatët për një vend pune zgjedhja e kandidatëve bëhet në afat prej 60 ditë, prej 201 deri në 500 kandidatët prej 90 ditë, mbi 500 kandidatët prej 120 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje. Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në arkivin e NP Komunalec – Kavadar, rr. “Industriska” pn..

NP Komunalec – Kavadar / UD Drejtori / Jurist i diplomuar I. Atanasov /

Në bazë të nenit 131 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016 и 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, me propozim të dekanit të Fakultetit të shkencave bujqësore dhe ushqimit në Shkup, publikon:

KONKURS

Për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën shkencore dhe mësimore:
➤ Fara jopjellore;

Kushtet: Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidati/tët duhet të dorëzojnë: biografi të shkurtë, deklaratë për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë. Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Orari i punës i mësimdhënësit është përcaktuar në pajtim me aktet e fakultetit. Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit. Dokumentet dorëzohen deri në Fakultetin e shkencave bujqësore dhe ushqimit – Shkup, bul. “Aleksandar Makedonski” pn, P.Fax 297, 1000 Shkup.

Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15 – tekst i pastruar), nenit 80 dhe nenit 82 të Ligjit për arsim fillor dhe pëlqimit nga MASH, SHFQ “Hristo Uzunov” – Drugovë, publikon

SHPALLJE

Për themelimin e marrëdhënies së punës për kohë të caktuar të punës për vitin shkollor 2016/2017 deri më 31.08.2017:

- 1. Një mësimdhënës të mesimit klasor me orar të plotë të punës (zëvendësim për drejtorin), me neto pagesë prej 22.210,00 denarë;
2. Një mësimdhënës të artit figurativ me 6 orë, me neto pagesë prej 6.318,00 den;
3. Një mësimdhënës të edukatës muzikore me 11 orë, me neto pagesë prej 11.365,00 den;
4. Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase me 8 orë, neto pagesa prej 8.261,00 den;

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim fillor, si dhe kushtet e parapara me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës. Orari i punës së mësimdhënësve është në pajtim me orarin e orëve. Orari javor i punës është 40 orë për orarin e plotë të punës, ndërsa orari jo i plotë është në pajtim me orarin e orëve.

Dokumentet e nevojshme:
- Lutje;
- Dokument (diplomë) për arsimin e mbaruar përkatës, në original ose kopje të vërtetuar në noter;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikatë të lindjes.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 5 ditëve të punës pas përfundimit të shpalljes. Dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri në SHFQ “Hristo Uzunov” – Drugovë. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

SHFQ “Hristo Uzunov” – Drugovë

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, Vendimit për nevojën për punëtor nr. 04-1249/1 të datës 20.12.2017, nenit 34 të Statutit të NP Komunalec Kavadar ndërsa në pajtim me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, UD Drejtori i ndërmarrjes

Publikon SHPALLJE Për pranim të punëtorëve

I. NP Komunalec – Kavadar ka nevojë për pranim të punëtorëve për kohë të caktuar për 9 (nëntë) muaj edhe atë për vendet e punës në vijim:

- 1. Punëtor i përgjithshëm në Departamentin për rrjetin urban dhe rural të ujësjellësit Sektori ujësjellës dhe kanalizim 3 (tre) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 03;
2. Larës në Departamentin për higjienë publike (shërbyese) Sektori për higjienë komunale 2 (dy) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 014.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- PKU, shkalla I e përgatitjes profesionale; Shuma në të holla e neto pagesës themelore të kandidatëve të kandidatëve të zgjedhur do të jetë 13.870,00 denarë ndërsa orari i punës do të jetë 8 orë në ditë ose 40 orë në javë prej ditës së hënë deri ditën e premtë.

Kandidatët krahas lutjes për punë të parashirojnë edhe dëshmi për arsimin e mbaruar si dhe dokumente me çka përmbushen kushtet e posaçme që janë të theksuara më lartë.

Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 i Ligjit për marrëdhënie pune gjegjësisht nëse në shpalljen publike janë paraqitur deri në 200 kandidatët për një vend pune zgjedhja e kandidatëve bëhet në afat prej 60 ditë, prej 201 deri në 500 kandidatët prej 90 ditë, mbi 500 kandidatët prej 120 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në arkivin e NP Komunalec – Kavadar, rr. “Industriska” pn.

NP Komunalec – Kavadar UD Drejtori /Jurist i diplomuar I. Atanasov/

Në bazë të nenit 22, dhe 23 të L.M.P(“Gaz.zyrtare e R.M” nr. 158/10, 47/2011, 11/2012, 39/2012), si dhe neni 80 dhe 82, prej L.A.F-it (“Gazeta zyrtare e R.M” nr 103/2008) dhe njoftimin nr. 12-9851/3/5 prej 11.12.2017 të M.A.SH-it . S.H.F “Naim Frashëri” –Negotinë e Pollogut me Shkollat periferike f.Sanakos, Kalisht, Gjurgjevisht, Llomnicë, publikon:

SHPALLJE

Për plotësimin e vendeve të punës për kuadrë arsimorë në gjuhën shqipe, për vitin shkollor 2017/2018 në kohë të caktuar pune deri më 31.08.2018.

- 1.Gjuhë shqipe- 2 përmbuarues(arsimtarë).
2.Gjuhë angleze – 5 përmbuarues(arsimtarë).
3.Gjuhë frënge -3 përmbuarues(arsimtarë)..
4.Gjuhë maqedonase - 5 përmbuarues(arsimtarë)..
5.Arsim muzikor- 1 përmbuarues(arsimtarë).., me fond jo të plotë 10 orë.
6.Matematikë - 5 përmbuarues(arsimtarë) ., 1 arsimtarë në zëvendësim të Nd. Drejtorit marshënia e punës do të zgjas deri në kthimin e Nd. Drejtorit në vendin paraprak të punës,më së voni deri më :31.08.2018.
7.Arsimi fizik dhe shëndetësor - 4 përmbuarues(arsimtarë).
8.Arsim figurativ -1 përmbuarues(arsimtarë).., me fond jo të plotë 10 orë.
9.Histori- 2 përmbuarues(arsimtarë).., 1 me fond jo të plotë 10 orë.
10.Projekte nga informatika- 1 përmbuarues(arsimtarë) . me fond jo të plotë 16 orë (lëndë zgjedhore).
11.Biologji -1 përmbuarues(arsimtarë). me fond jo të plotë 16 orë.
12.Arsimi qytetar, Etikë, Inovacione -1 përmbuarues(arsimtarë) me fond jo të plotë 11orë.
13.Grupi klasor- 8 përmbuarues(arsimtarë), 1 arsimtarë në zëvendësim të Drejtorit marshënia e punës do të zgjas deri në kthimin e Drejtorit në vendin paraprak të punës,më së voni deri më :31.08.2018.
14.Fizikë- 1 përmbuarues(arsimtarë), me fond jo të plotë 10 orë.
15.Kimi -1 përmbuarues(arsimtarë),me fond jo të plotë 10 orë.
16.Shkencat natyrore-2 përmbuarues(arsimtarë), njëri me fond jo të plotë 10 orë.

Me paraqitjen për pos lutjes , kandidatët janë të obliguar të dorzojnë edhe dëshmitë e nevojshme në original ose kopje të verifikuara në noter , në pikpamje të kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta të parapara në ligj edhe atë: Diplomë për kryerjen e shkollimit edukat e cila kërkohet për vendin e punës;Nënshtrisi;Vërtetim se nuk i është shqiptuar vendim gjyqësor për kryerjen e profesionit veprimtarisë ose detyrës. Shpalljen publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e shpalljes.përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat prej 45 ditëve.

Orari javor i punës është nga e Hëna deri në të Premte ndërsa Rroga bazë neto është në shumë prej :20.644.00 denarë.

Paraqitja e dokumenteve të pakompletuara nuk do të shqyrtohet .Dokumentet e nevojshme dërzohen personalisht ose në zarfë të mbyllur me shtojcë “Të mos hapet” në këtë adresë SH.F “Naim Frashëri” – Negotinë e Pollogut ,komuna e Vrapçishtit, me shenjë “ për shpallje”

SH.F “Naim Frashëri”-Negotinë komuna e Vrapçishtit

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr. 62/2005 dhe 113/2014),nenit 4 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr. 27/2014,199/2014 dhe 27/2016),Pëlqimit nga Ministria e arsimit dhe shkencës nr. 12-11176/2 të datës 11-12-2017. SHFK. Faik Konica“ f. Silupcan më datë 21-12-2017. publikon:

Numri i arkivimit 04-837/1 Data 21-12-2017.

SHPALLJE

Table with 4 columns: Nr. (1), Nje (1), Arsimit (1), and details of teaching positions in various subjects like Mathematics, Physics, Chemistry, Biology, and Music, including salaries and working hours.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet sipas Ligjit për arsimin fillor. Të gjitha vendet e punës janë me afat të caktuar kohor deri më 31.08.2018. Procesi edukativo-arsimor në shkollë zhvillohet në gjuhën mësimore shqipe. Kandidatët Lutjes për punë duhet t'i bashkëngjisin këto dokumente:
- Diplomën ose Certifikatën për arsimimin e kryer (original ose kopje e notarizuar)
- Certifikatën për gjendjen shëndetësore,
- Certifikatën e shtetësisë,
- Certifikatën nga Gjyqi se nuk janë të dënuar për vepra kundër moralit dhe dinjitetit. Shpallja mbetet e hapur 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor,ndërsa dokumentet dërgohen në SHFK. Faik Konica“ f. Silupcan. Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Drejtori i shkollës / M-r Nagbi Avdja /



Diego Simeone



Luis Enrique



Hoze Murinjo



Antonio Conte



Vila Boas



Mauricio Pochettino



Karlo Anceloti

SHTATË TRAJNERËT QË PRITET TË ZËVENDËSOJNË EMERIN

Trajneri që më shumë e josh Al-Khelaifin është Simeone, por situata me të duket e komplikuar dhe ka gjasa që Luis Enrique të fitojë mbi të gjithë

Unai Emery mund t'i japë fund karrierës së tij të PSZH në verën që vjen, ose edhe më parë, përveç nëse kryen një sukses të madh në Ligën e Kampionëve. As fitimi i Ligue 1 nuk mund ta shpëtojë atë dhe klubi parisien tashmë ka një listë prej gjashtë zëvendësuesish të mundshëm. Trajneri që më shumë e josh Al-Khelaifin është Simeone, por situata me të duket e komplikuar dhe ka gjasa që Luis Enrique të fitojë mbi të gjithë.

DIEGO SIMEONE

PSZH ka një dobësi për argentinasi dhe beson se trajneri aktual i Atletiko Madrid është personi ideal për t'u përballur me një projekt afatgjatë, të mbështetur nga puna. Por "Cholo" nuk duket se do ta lërë punën në "Wanda Metropolitan", akoma. Dhe ai gjithmonë ka thënë se do të dëshironte



të stërviste në Itali dhe veçanërisht Interin.

LUIS ENRIKE

Spanjolli ka qenë pa ekip që nga vera e kaluar, kur vendosi të largohet nga Barcelona. Disa media franceze dhe angleze bëjnë me dije se Al-Khelaifi ka lëvizur tashmë, disa javë më parë, dhe mund të ketë rënë dakord që Luis Enrique dhe PSZH "të fluturojnë" së bashku pas poshtërimit 6-1 të fundit në Çampions.

HOZE MURINJO

Është padyshim një alternativë tjetër për t'u vlerësuar. Al-Khelaifi

dhe portugezi kanë mbajtur një marrëdhënie të mirë për vite me radhë dhe trajneri i Mançester Junajted nuk e ka fshehur kurrë dashurinë që ndjen për Parisin. "Nuk do të jem gjithë jetën time te Mançester", – paralajmëroi ai pak kohë më parë. Përveç kësaj, Junajtedi nuk ka një sezon të mirë në Premier Ligë (13 pikë mbas Mançester Siti), ndaj gjigandët parisienë mund të jenë "stacioni" i radhës për "Special one".

ANTONIO KONTE

Italiani duket se i ka muajt të numëruar te Çells. Kampioni aktual i Premier Ligës nuk po iu

përgjigjet pritshmërive, pavarësisht disbursimit të bërë këtë verë me Alvaro Morata. Rezultatet e këqija (16 pikë larg Siti) dhe komunikimi i dobët me një pjesë të lojtarëve japin të dhëna për largimin e tij të mundshëm. PSZH është në gatishmëri, por Konte duket se mendon vetëm për ekipin kombëtar italian, i cili gjendet pa trajner qëkur Ventura nuk arriti të kualifikohet për Kupën e Botës në Rusi.

VILA BOAS

Ai nuk është një trajner i rangut të lartë, megjithëse në "palmaresin" e tij ka një "Europa League" të fituar me Porton në vitin 2011. Në sajë të

këtij trofeu ai u bë trajneri më i ri që fiton një Kupë Evropiane. Ishte 33 vjeç. Ai pastaj vendosi të fillojë ëndrrën kineze me SIPG Shanghai, por një ofertë nga PSG mund ta kthejë në futbollin evropian.

MAURISIO POKETINO

Në krye të Totenhemit është duke shkëlqyer nga rezultatet dhe nga futbollin. Ndheshja në "White Hart Lane", kundër Real Madridit në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve e shpërfaqti figurën e tij në të gjithë Evropën, deri në pikën e "ringjalljes" për stolin e "Los Blancos" në të ardhmen. Antero Henrique e vuri në dukje emrin e tij në listë, edhe pse Al-Khelaifi ende dyshon për përvojën e tij në Evropë.

KARLO ANÇELOTI

Një tjetër opsion është kthimi i Ancelotit. Ky është opsioni i fundit i klubit parisien, por italianin ka përvojë të mjaftueshme për të arritur sukses dhe siguron një akordim të mirë me një dhomë zhveshesh disi të tmerrshme, pas ardhjes së Nejmar. Anceloti është personi ideal për të trajtuar egot e yjeve të PSZH.

Publicitet

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimit Hapësinor

MKD
СЕРТИФИКАТ
MKC EN ISO 9001:2009

Në bazë të nenit 86 paragrafi 1 dhe nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit të Mjedisit Jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 42/2014, 44/2015, 129/2015 dhe 39/2016), dhe neni 4 i Rregullores për formën, përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e përgatitjes së raportit për adekuatshmërinë e studimit të vlerësimit të ndikimit të projektit të mjedisit jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 33/06), njoftohet publiku se Komisioni për përpunimin e raportit për adekuatshmërinë e Studimit të vlerësimit të ndikimit të mjedisit jetësor të projektit: "Vendosja e sistemit të integruar dhe financiarisht të vetë-qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Vardarit" përgatiti

RAPORT

për adekuatshmërinë e studimit të vlerësimit të ndikimit të mjedisit jetësor të projektit "Vendosja e sistemit të integruar dhe financiarisht të vetë-qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Vardarit",

1. Investitor: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Selia: bul. "Goce Dellçev" nr. 18, Shkup
Personi kontaktues: Jadranka Ivanova,
E-mail: jivanova@moepp.gov.mk

2. Shtëpia konsultuese e cila e përgatiti Studimin e vlerësimit të ndikimit të mjedisit jetësor: ENVIROPLAN S.A.
Personi për kontakt: Fana Hristovska, eksperte e VNMJ
E-mail: fhristovska@yahoo.com

3. Përshkrim i shkurtër i projektit të propozuar:
Qëllimi i këtij projekti është vendosja e sistemit të integruar dhe të vetë-qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave. Parashihet ndërtimi i tre stacioneve të transferimit. Komunitat në të cilat do të ndërtohen stacionet e transferimit në rajonin e Vardarit janë: Stacioni i transferimit në Veles, ku do të shërbehen Velesi, Llozova dhe Çashka, Stacioni i transferimit në Kavadar, nga i cili do të shërbehen komuna e Kavadarit dhe Stacioni i transferimit në Negotinë, ku do të shërbehen komuna e Negotinës dhe e Demir Kapisë. Me këtë projekt parashihet ndërtimi i instalimit qendror për menaxhimin e mbeturinave që parashihet të gjendet në komunën e Rosomanit.

4. Informacione shtesë mund të merren në Sektorin e Komunikimit me Publikun rr. "Kej Dimitar Vlahov" Nr. 4 tel. 3 251 449 dhe Drejtorinë e Mjedisit Jetësor në ndërtesën e MTV bul. Goce Dellçev bb Tel. 3 251 462 pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor si dhe në faqen e internetit të Ministrisë, www.moepp.gov.mk

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimit Hapësinor

MKD
СЕРТИФИКАТ
MKC EN ISO 9001:2009

Në bazë të nenit 86 paragrafi 1 dhe nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit të Mjedisit Jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 42/2014, 44/2015, 129/2015 dhe 39/2016), dhe neni 4 i Rregullores për formën, përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e përgatitjes së raportit për adekuatshmërinë e studimit të vlerësimit të ndikimit të projektit të mjedisit jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 33/06), njoftohet publiku se Komisioni për përpunimin e raportit për adekuatshmërinë e Studimit të vlerësimit të ndikimit të mjedisit jetësor të projektit: "Vendosja e sistemit të integruar dhe financiarisht të vetë-qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Pellagonisë" përgatiti

RAPORT

për adekuatshmërinë e studimit të vlerësimit të ndikimit të mjedisit jetësor të projektit "Vendosja e sistemit të integruar dhe financiarisht të vetë-qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Pellagonisë",

1. Investitor: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Selia: bul. "Goce Dellçev" nr. 18, Shkup
Personi kontaktues: Jadranka Ivanova,
E-mail: jivanova@moepp.gov.mk

2. Shtëpia konsultuese e cila e përgatiti Studimin e vlerësimit të ndikimit të mjedisit jetësor: ENVIROPLAN S.A.
Personi për kontakt: Aneta Kitevska, eksperte e VNMJ
E-mail: akitevska@yahoo.com

3. Përshkrim i shkurtër i projektit të propozuar:
Qëllimi i këtij projekti është vendosja e sistemit të integruar dhe financiarisht të vetë-qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave. Në rajonin e Pellagonisë, planifikohet ndërtimi i dy stacioneve të transferimit. Komunitat në të cilat do të ndërtohen stacionet e transferimit janë: stacioni i transferimit në Resnjë dhe stacioni i transferimit në Krushevë. Me këtë projekt parashihet ndërtimi i një instalimi qendror i menaxhimit të mbeturinave, që planifikohet të gjendet në komunën e Novacit.

4. Informacione shtesë mund të merren në Sektorin e Komunikimit me Publikun rr. "Kej Dimitar Vlahov" Nr. 4 tel. 3 251 449 dhe Drejtorinë e Mjedisit Jetësor në ndërtesën e MTV bul. Goce Dellçev bb Tel. 3 251 462 pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor si dhe në faqen e internetit të Ministrisë, www.moepp.gov.mk

SHFK "Manush Turnovski" Novo Sellë, më datë 23.12.2017 ka publikuar shpallje për vitin shkollor 2017/18 me numër 04-444/2 të datës 22.12.2017. Shpallja e publikuar nuk përshtatet me pëlqimin nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe prandaj kërkohet anulimi i pikës 15 të të njëjtës shpallje.

SHFK "Manush Turnovski" Novo Sellë
Drejtor: Lençe Karaçanakova



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Njoftim

Universiteti i Evropës Juglindore shpall thirrje publike për sa vijon:
• Thirrje publike numër 01/122017 - Shërbime të telekomunikacionit
Të gjithë të interesuarit mund të marrin informata më të hollësishme në:
www.seeu.edu.mk/sq/information/tenders

SALAH TREGON SAKRIFICAT
E PABESUESHME QË AI KA BËRË
KUR ISHTE I RI

BËJA 9 ORË RRUGË ME AUTOBUS PËR 2 ORË STËRVITJE

Në një intervistë për faqen zyrtare të Liverpoolit në internet, i pandalshmi Mohamed Salah ka folur për sakrificat e pabesueshme që ai ka bërë kur ishte i ri



Nuk mund t'ia u garantoj se kisha bindjen që do t'ia dilja, por që në moshën 14-vjeçare flija duke menduar se do të bëhem një ndër futbollistët më të mirë. Por ndoshta kjo është ëndrra e çdo 14-vjeçari

Një histori që ju jep panoramën e vështirësive të jashtëzakonshme gjatë udhëtimit të tij në sportin më të bukur. Salah tregon se ishte mësuar të nisej që në 9:00 për në fushën stërvitore dhe të kthehej në shtëpi në 22:00 ose 22:30, duke marrë të paktën pesë linja të ndryshme autobusi që të mbulonte këtë distancë. "Në fillim luajta për një klub që ishte gjysmë ore larg fshatin ku kam lindur në Basyoun", – tha sulmuesi. "Më pas firmosa për një klub në Tanta, që është një orë e gjysmë larg. Prej aty shkova te 'Arab Contractors' në Kairo, kështu që më duhej të

udhëtoja 9 orë në ditë, katër orë e gjysmë vajtje, katër orë e gjysmë ardhje, për pesë ditë në javë, vetëm që të stërvitesha. E lashë shkollën shumë i vogël që të merresha me stërvitjen. Në fillim shkova nga ora 07:00 deri në 09:00 sepse paraqitja një leje nga klubi që më lejonte të largohesha. Kjo dalë nga dalë u bë e pamundur. Por mendoj se tani gjithçka do të kishte vazhduar të ishte po aq e vështirë nëse nuk do të isha bërë futbollist", shtoi më tej Salah. "Për pesë ditë në javë, çdo javë për tre apo katër vjet, unë do të bëja këtë rrugë: Dilja në 9 të mëngjesit për të mbërritur në një

fushë stërvitore rreth orës 2 apo 2 e gjysmë në drekë. Stërvitja fillonte në 16:00. E mbaroja stërvitjen rreth orës 18:00. Mbërrija në shtëpi në dhjetë të darkës, ushqehesha, flija gjumë dhe të nesërmen bëra të njëjtën gjë. Dhe kjo nuk ishte vetëm me një autobus. Më duhej të hipja në tre, katër apo pesë linja të ndryshme, vetëm që të shkoja në stërvitje dhe më pas të kthehesha në shtëpi" – tregon futbollisti që i dha fund "skamjes" në momentin që firmosi kontratën me Bazelin, në moshën 19-vjeçare. Salah u zgjodh futbollisti më i mirë afrikan në vitin dhe gjithash-



Për pesë ditë në javë, çdo javë për tre apo katër vjet, unë do të bëja këtë rrugë: Dilja në 9 të mëngjesit për të mbërritur në një fushë stërvitore rreth orës 2 apo 2 e gjysmë në drekë. Stërvitja fillonte në 16:00. E mbaroja stërvitjen rreth orës 18:00. Mbërrija në shtëpi në dhjetë të darkës, ushqehesha, flija gjumë dhe të nesërmen bëra të njëjtën gjë

tu po shkëlqen në Premier League ku në muajin nëntor doli lojtari më i mirë i kampionatit anglez. Për të, rikthimi në Anglo, pas përvojës së hidhur me Çellsin, ka rezultuar një lëvizje e shkëlqyer. Salah e ka pasur gjithmonë ëndrrën për t'u bërë një nga më të mirët. "Ashtu si e thashë ishte një kohë shumë e vështirë për mua por unë isha i ri, një fëmijë dhe gola të bëhesha futbollist. Unë doja që të vija emër në futboll dhe me këtë ëndërr flija çdo natë. Doja të bëhet lojtar i veçantë, ndër më të mirët", – tregon ai.



MESSI, "VIGANI" I REAL MADRIDIT

Leo Messi i dha fund takimit të tij të jashtëzakonshëm me një ekspozitë të re në "Santiago Bernabéu". Argjentinasin e udhëhoqi ekipin e tij në fitoren 3-0 kundër Real Madridit. Messi luan me një motivim të veçantë kur përballet me Real Madridin dhe më shumë kur luan në "Santiago Bernabéu". Në fakt, ai ka fituar më shumë "El Clásico" në fushën e Real Madridit se në "Camp Nou". Të shtunën e

kaluar ishte fitorja e tij e dhjetë në 19 ndeshje të luajtura në "Bernabéu", gjë që e bën atë lojtarin rival, i cili ka fituar më së shumti në fushën e Real Madridit. Përveç kësaj, Leo shënon më shumë gola në "El Clásico" e luajtura në Madrid se sa në Barcelonë. Nga 25 gola të shënuar kundër Real Madridit, 15 i ka realizuar në kryeqytetin spanjoll dhe 10 në "Camp Nou". Ai është, gjithashtu lojtari, që ka shë-

nuar më shumë gola në historinë e klasikeve, duke tejkaluar lojtarë si Di Stefano apo Kristiano Ronaldo, të cilët arritën përkatësisht 18 dhe 17 gola. Argjentinasin është, gjithashtu, ai që ka shënuar më shumë gola me penallti në klasike. Ai ka transformuar gjashtë 11-metërshat në gola ndaj të bardhëve dhe shkalla e suksesit në këtë drejtim është 100%. Goli i të shtunës kundër Real Madridit e konsoli-

don atë si golashënuesin më të mirë në La Liga për këtë sezon, me 15 gola dhe e bën atë lojtarin e parë në historinë e La Liga-s që shënon të paktën 15 gola më shumë se 10 sezonet rresht. Messi arriti të bëhet lojtari me më shumë gola, që i ka shënuar Real Madridit në historinë e La Liga-s. Shuma e këtyre golave shkon në 17, një më shumë se Zarra, Igoa dhe Gorostiza. Përveç kësaj, ai përfundoi pje-

sëmarrjen e tij të 200-të në Barcelonë. Një tjetër figurë historike, numri 10 e Barçës e mbyll vitin 2017 në krye të statistikave kryesore evropiane. Ai është lojtari që shënoi më shumë gola në vitin 2017 (54). Vetëm Harri Kin mund ta mundë atë. Sulmuesi i Totenhamit ka 53 gola, në mungesë të një ndeshjeje në Premier Ligë, që do të luhet të martën, për vitin që po lëmë pas.



DASHI 21. mars - 20. prill

Kjo dite do jete pozitive për ju te dashuruarit. Do i arrini te gjitha objektivat qe do i vini vetes dhe do ndiheni krenare. Pasdite përgatituni për ndonjë surprize nga partneri. Beqaret do kenë disa takime, por me mire te mos nxitohen për t'i dhënë fjalën dikujt. Ne planin financiar do e keni me te qarte situatën ne te cilën ndodhëni dhe do hidhni hapat e duhura për ta përmirësuar me tepër.



DEMI 21. prill - 21. maj

Jeta juaj ne çift nuk do jete shume e mire gjate kësaj dite. Secili do ketë idetë dhe mendimet e tij lidhur me një çështje dhe duke mos hapur rruge situata mund te behet problematike. Beqareve do iu jepen mundësi te shkëlqyera sot për te filluar një lidhje kështu qe duhet te jene te kujdesshem dhe te përfitojnë sa me tepër. Ekuilibri financiar ne shume momente do jete i trazuar.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Do jeni akoma me tolerante sot ju te dashuruarit dhe marrëdhënia me partnerin do vije duke u përmirësuar. Nëse vazhdoni me këtë mënyrë sjelljeje shume shpejt do merrni edhe një vendim te rëndësishëm. Beqaret do kenë vetëm dashuriqka kalimtare dhe pa ndonjë te ardhme. Ne planin financiar do dini si t'i kryeni me kujdes e maturi shpenzimet kështu qe gjendja do mbetet e mire.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Ju qe jeni ne një lidhje ka mundësi te merrni disa vendime te mëdha sot dhe do futeni ne një etape shume me te bukur. Pasdite dhe ne mbrëmje nuk do mungojnë as surprizat. Beqaret nuk do ndihen gati për te qene çift dhe gjithë kohen e lire do ua kushtojnë familjareve. Nëse me shpenzimet tregoheni impulsive, situata financiare do marre tatëpjetën e shume shpejt do mbeten pa para.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Çdo gjë do ece ashtu si e kishit planifikuar sot ju te dashuruarit. Komunikimi do jete i kënaqshëm dhe për këtë do ju kenë zili te gjithë. Beqaret nuk do ndihen te lire te bëjnë atë qe do ndiejnë dhe ka mundësi te mbeten serish vetëm. Me shpenzimet do jeni goxha impulsive dhe ka mundësi te bëni gabime te pafalshme e me pasoja tek e ardhmja.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Nëse jeni ne një lidhje mundohuni te jeni me liberale dhe nga ana tjetër t'ua vini me shume veshin këshillave te partnerit. Vetëm kështu marrëdhënia ne çift do ece si duhet. Beqaret do kenë shume komplekse dhe nuk do i pranojnë ftesat qe do iu bëhen. Ne planin financiar do ketë disa përmirësime te vogla, por qe do ju bëjnë te ndiheni shume me mire nga pak dite me pare.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Dite e këndshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do jeni te logjikshëm për çdo gjë qe do thoni e qe do bëni prandaj mes jush dhe partnerit nuk do linde asnjë mosmarrëveshje. Beqaret do jene te interesuar për flirte dhe aventura kalimtare, te cilat për te thënë te vërtetën do jene me shumice. Financat duhet t'i keni me tepër ne vëmendje dhe gjendja ka për t'u përmirësuar shpejt.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Për gjithë ata qe janë ne një lidhje, kjo e sotmja ka për te qene shume e bukur dhe me diell. Do argëtohen pafund pranë njeri-tjetrit dhe debatet do mungojnë tërësisht. Beqaret do afrohen goxha pas disa miqve dhe do fillojnë te kenë ndjesi te veçanta për ta. Financat do jene shume me te kënaqshme, megjithatë mire është qe përveç shpenzimeve te domosdoshme te mos e teproni.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Dite e paqëndrueshme ka për te qene kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do keni shpesh kontradikta me partnerin, por pas pak minutash do pendoheni për ato qe keni thënë dhe do kërkoni falje me mënyrë te veçanta. Beqaret nuk duhet kurrsesi te mbyllin sytë dhe te hedhin hapa sepse mund te lëndohen. Për menaxhimin e financave me mire këshillohuni me specialistet dhe do dilni te fituar.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Ka shume mundësi te mos i qëndroni besnike partnerit tuaj gjate kësaj dite dhe kjo do sjelle probleme te mëdha. Nga një gabim i pamenduar mund te shkatërroni gjithçka te bukur qe e keni ndërtuar me mundim. Beqaret do kenë disa takime, por do ju duhet kohe qe te vendosin e te bëjnë zgjedhje. Ne planin financiar nuk ka për te pasur vështirësi te mëdha kështu qe pjesën me te madhe te kohës do ndiheni te qete.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Nëse keni ndonjë dyshim për partnerin tuaj mundohuni te flisni sa me hapur me te qe te sqaroni gjithçka. Nëse mundoheni ta kontrolloni fshehurazi keni për te pasur vërtet probleme. Beqaret ka mundësi t'i rikthehen një dashurie te shkuar, por kësaj here do përjetojnë emocione shume te forta. Financat do i mbani gjate gjithë kohës nen kontroll dhe nuk do ju dalin te papitura.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Sot do jeni shume me optimiste ju te dashuruarit dhe do bëni gjithçka qe te kaloni çaste te lumtura me atë qe keni ne krah. Buzëqeshja dhe emocionet do mbizotërojnë ne çdo moment. Për beqaret nuk do ketë ndryshime te mëdha edhe sikur te bëjnë përpjekje te mëdha. Me shpenzimet do jeni shume te logjikshëm kështu qe gjendja do vazhdoje te mbetet e mire dhe aspak problematike.



Mensur Mamuti	LËNG PËR LARJE TE TRUPIT APO TE FLOKËVE	KËNGËTAR ITALIAN, PARTNERI I ROMINA PAUER	QYTET NË KROACI	VEGËL PËR TË PRERË DRU, TESTERE	KOMUNË NË ITALI ANGSTREMI				
VENDLINDJAE POLITIKANT NË FOTO							EDGAR ALLAN PO	AUSTRIA	
BIMË E THJESHTË QË RRITET NË VENDE ME UJË						DEVOTSHMËRI (ARAB.) JODI			
KRENARI							IRIDIUMI	POETI YNË, ASLLANI	LLOJ CEKANI QË PËRDORET PËR TE THYER GURË
ÇIFT LLOJ KALI SKOCEZ						KOKËFORTË, KRYENEÇ	LUAN TOPÇIU		
P				VËLLA I MADH SPANJA				OKSIGJENI AMPERI	
GRUP MUZIKOR PREJ NËNTE ANËTARESH							EMRI I NJUTNIT		

ZGJIDHJET: T, AMPER, AONI, OPEK, CULE, JELLAK, DOP, URAL, ANELA, SHAOSHAN, EAP, ALGA, TAKVA, MBURJE, IR, PALE, NANAÇ, PONI, LALE, O, NONET, ISAK

Sudoku

shumë i lehtë

		7		2		5		
		8	6	5	1	4		
	9							1
	7			9				5
3	4		8		7		2	1
	6			3			4	
	2						9	
		3	2	4	9	7		
		9		7		1		

mesatar

								3
	6			2				1
4	5	1						2
			5					
					8		7	
	5	4			2			6
					7			
	8	3						2
		1	4	6		9		

Shumë i lehtë: 617924538, 238651479, 594783216, 871492653, 345867921, 962135847, 726518394, 183249765, 459376182. Mesatar: 219845673, 867329514, 435176892, 678513249, 392684751, 154792368, 946237185, 783951426, 521468937.

DEL NË SHITJE LAMBORGHINI I KEKE ROSBERG



Të gjithë admiruesve e Lamborghini-t, ka dalë në shitje një nga makinat më emblematike të kësaj marke. Bëhet fjalë për një version 5000 Quattrovalvole, pronari i parë i të cilit ka qenë Keke Rosberg, babai i Nico Rosberg dhe kampion i Formulës 1

në vitin 1982. Makina sportive ka një motor V12 prej 5.2 litrash dhe 48 valvula, që e lejon të arrijë një shpejtësi deri në 292 km/h. Nga 0 deri në 100 km/h shkon për 4.8 sekonda. Çmimi? Plot 920.000 euro.

Popullsia e botës do të jetë 7.6 miliardë në fillim të 2018-ës

Popullsia botërore pritet të arrijë rreth 7.6 miliardë banorë në fillim të vitit tjetër, njoftoi sot Fondacioni Gjerman për Popullsinë Botërore (DSW). Instituti pret që numri total i njerëzve në Tokë të arrijë afërsisht 7.591.541.000 në 1 janar. Vitin e kaluar, numri i popullsisë u rrit me 83 milionë ose afërsisht sa popullsia e Gjermanisë. Numri i personave në Afrikë pritet të rritet veçanërisht me shpejtësi në dekadat e ardhshme. Popullsia e këtij kontinenti pritet të arrijë 2.53 miliardë banorë deri në vitin 2050, nga 1.26 miliardë që është aktualisht.

KUSH ËSHTË MË I LUMTUR, I MARTUARI APO BEQARI?



Të martuarit kanë shumë arsye për të qenë të lumtur: i ndajnë shpenzimet financiare, mund të jetojnë pa frikën se do të vdesin në vetmi dhe mund të shpenzojnë kohë me çifte tjera të martuara. Por, ka edhe një arsye tjetër se përse të martuarit ndihen mirë për vetveten. Sipas një studimi të ri, individët të cilët janë të martuar kanë mirëqenie më të mirë dhe janë të kënaqur më shumë në jetë. Në letrën e publikuar në 'Journal of

Happiness Studies', hulumtuesit kanë marrë të dhëna nga dy anketime të Mbretërisë së Bashkuar për t'i ekzaminuar përfitimet e martesës. Pas ekzaminimit të tërësishëm të të dhënave, shkencëtarët kishin zbuluar se martesë në mënyrë drastike ndikon në rritjen e kënaqësisë në jetë, e veçanërisht tek ata që i afrohen moshës së mesme. Edhe miqësia mes të martuarve është çelës për një jetë të gjatë e të mbushur me lumturi.

MINJTË "BASTISIN" ZYRAT QEVERTARE NË PARIS, QEVERIA "PUNËSON" MACE

Parisi nuk është i njohur vetëm si qyteti ku ndodhet Kulla Eiffel, por edhe për problemin e tij shumë serioz me minjtë. E tani, brejtësit janë shfaqur e kanë ndërtuar shtëpi edhe në ndërtesa qeveritare, duke i bërë zyrtarët të zhvillojnë reflekset e tyre "prej maceje". Ministria e Brendshme dhe zyrtarët e zëdhënës të Qeverisë, Christophe Castaner, kanë qenë dy ndërtesat kryesore të pushtuara nga minjtë. Pas tyre, të njëjtin fat pati edhe Ministria franceze e Punë-



ve të Jashtme, por kjo e fundit duket se e ka gjetur zgjidhjen: Ka punësuar dy mace, të cilat do të enden në të gjithë godinën për të shfarosur vizitorët e padëshiruar. Dy macet janë quajtur Nomi dhe Noe, në nder të Mbretit të parë të Britanjes, Nominos. Që prej vitit 2016, zyrtarët e qytetit kanë ndërmarrë një seri masash për të luftuar fluksin e pazakontë të minjve në Paris.

1492 - Banorët e parë spanjoll në Botën e Re të zbuluar nga Kolombo.

1748 - Franca dhe Austria nënshkruajnë traktat për Holandën Jugore.

1944 - Budapesti rrethohet nga ushtria ruse.

1978 - Ish Kryeministria e Indisë Indira Gandhi lirohet nga burgju.

1979 - Forcat Speciale Sovjetike marrin Pallatin presidencial në Kabul të Afganistanit.

1998 - Iraku deklaroi se do të gjuajë aeroplanët ushtarak amerikan dhe britanik, të cilët patrollojnë mbi pjesën veriore dhe jugore të zonës për ndalim të fluturimeve.

1999 - Koha e keqe në Francë merr jetën e mbi 100 personave dhe shkakton dëme të jashtëzakonshme mbi bimët dhe rrjetin elektrik nacional të Francës.

Mjalti është ilaçi i vetëm për shërimin e të rrahurit të shpejtë të zemrës (tahikardia). Kur hahet mjalti lukthi punon në rregull dhe nuk nevojiten pluhura dhe ilaçe për të ndihmuar përpunimin. Mjalti që pihet i nxehtë për 7 minuta përzihet me gjakun, ndërsa i ftohtë për 20 minuta. Të sëmurët nga verdha, në qoftë se mëngjes dhe mbrëmje hanë mjaltë, për 15-20 ditë ajo do të shërohet. Nëse mjalitin lyeni mbi material të nxehtë dhe atë e veni mbi qafë ose në gjoks, dhembjet e fytyrës menjëherë largohen. Kjo bëhet kur kemi ndezje të krajkave dhe anginë. Mjalti ndihmon në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve.



A KE QENË TE MJEKU?

- Takohen dy shokë dhe njëri e pyet tjetrin: Kam dëgjuar që ke pas probleme me zemër. A ke qenë te mjeku?
- Po kam qenë
- E çfarë të tha?
- Duhet ta heqë skarën dhe ushqimin e yndyrshëm nga menyja. Duhet ta lë duhanin, birrat, rakinë dhe duhet të pi vetëm ujë. Pastaj më tha se duhet të mos shikojë më futboll dhe nuk guxoj t'i ndjekë më gratë e hallkut. Me fjalë tjera, duhet ta ndryshojë jetën time krejtësisht!
- E çfarë ke vendosur të bësh?
- Do ta ndryshojë mjekun!



Nuk ke pse bëhesh i famshëm. Duhet thjesht që t'i bësh prindërit krenarë. (Meryl Streep)



KALENDARI HISTORIK 26 DHJETOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS